

Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS)

PROJEKTI PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR TË KOSOVËS

Shkurt 2019

Përmbajtja

1	HYRJE.....	5
2	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE	6
3	LinJAT E MBËSHTETJES FINANCIARE	7
3.1	Linja e mbështetjes financiare për investime	7
3.2	Linja e përkrahjes financiare për ngritjen e kapaciteteve.....	8
4	POLITIKAT E BB TË CILAT ZBATOHEN PËR PROJEKTIN.....	9
5	HISEDARËT.....	11
6	PASQYRA E LEGJISLACIONIT KOMBËTAR.....	12
7	INVESTIMET QË KUALIFIKOHEN DHE QË NUK KUALIFIKOHEN	14
7.1	Aktivitetet që janë përjashtuar nga KCGF	14
7.2	Përjashtimet nga politikat e BB.....	14
7.3	Llojet e tjera të projekteve që nuk kualifikohen.....	15
8	VLERËSIMI MJEDISOR DHE KATEGORITË E SHQYRTIMIT	15
8.1	Kërkesat e rregullores për VNM të Kosovës	15
8.2	Kategoritë e shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve mjedisore të BB	16
8.3	Dokumentet për kujdesin e duhur mjedisor	20
8.4	Auditimi mjedisor (Raporti).....	20
9	PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE	20
9.1	Vlerësimi Social	21
9.2	Mekanizmi i Zgjidhjes së Ankesave	21
10	DOKUMENTET E KUJDESIT TË DUHUR, KONSULTIMIT PUBLIK DHE pubLikimit.....	22
11	PROCESI I SHQYRTIMIT MJEDISOR (RFI-të, FKGK DHE BB)	23
11.1	Monitorimi dhe raportimi	24
SHTOJCA 1	– PËRGJEGJËSITË KRYESORE TË PJESËMARRËSVE KRYESORË..	25
SHTOJCA 2	– LISTA KONTROLLUESE E PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR.	26
SHTOJCA 3	– SHABLLONI I PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL	34
SHTOJCA 4	– PROCESVERBALI I TAKIMEVE KONSULTATIVE PËR KMSM	37

SHTOJCA 5 – ProjeKTET E LISTUARA NË SHTOJCËN I TË LIGJIT PËR VNM PËR TË CILAT KËRKOHET VNM.....	43
--	-----------

SHTOJCA 7 – ListA E AKTIVITETEVE QË I NËNSHTROHEN LEJES MJEDISORE KOMUNALE.....	51
--	-----------

SHTOJCA 8 – SISTEMET EKZISTUESE TË SHQYRTIMIT TË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE MJEDISORE DHE TË MENAXHIMIT TË BANKAVE KOMERCIALE (RFIS).....	53
--	-----------

Procedurat e menaxhimit mjedisor dhe social të ProCredit Bank **Error! Bookmark not defined.**

Procedurat e menaxhimit mjedisor dhe social të Raiffeisen Bank Kosovë 53

Procedurat e menaxhimit mjedisor dhe social të bankës TEB Kosova 54

Shkurtesat

VM - Vlerësimi Mjedisor

KMSM- Korniza e Menaxhimit Social dhe Mjedisor

PMMS - Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

SMMS – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

IF – Institucion Financiar

IFR – IF i Regjistruar

FKGK - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

SH&S - Shëndeti dhe Siguria

SHSP - Shëndeti dhe Siguria Profesionale

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

LMK – Leja Mjedisore Komunale

NMVM - Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme

UA – Udhëzim Administrativ

VËREJTJE

Ky është një përkthim jozyrtar, jonormativ i këtij draft dokumenti, i cili nuk përcakton versionin final zyrtar. Nëse ndonjë pjesë e përkthyer në këtë dokument nuk është në përputhje me versionin në gjuhën Angleze, versioni në gjuhën Angleze mbizotëron. FKGK nuk merr përgjegjësi për ndonjë pasaktësi në përmbajtje të këtij draft dokumenti.

1 HYRJE

Me popullsi prej rreth 1.8 milion, Kosova është një nga vendet më të varfëra të Evropës, me pothuajse një të tretën e popullsisë që jeton nën vijën e varfërisë kombëtare. Në të njëjtën kohë, me shtetësinë e re dhe me moshën mesatare të popullsisë së saj (26 vjet) Kosova është vendi më i ri në kontinent, me mundësi dhe sfida të reja. Normat e papunësisë janë gjithashtu shumë të larta - në vitin 2015 gati një e treta e fuqisë punëtore ishin të papunë; në mesin e të rinjve shkalla e papunësisë ishte më shumë se 57 për qind.

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) luajnë rol kritik në krijimin e vendeve të punës. Sipas Raportit të Bankës Botërore për Diagnozën e Vendeve të Punës (2017), Kosova dallohet në krahasimet ndërkombëtare sa i përket kontributit më të madh të mikro-firmave në punësim. NMVM-të përbëjnë 65 për qind të punësimit, ndërsa vetëm ndërmarrjet mikro sigurojnë 36 për qind të punësimit të përgjithshëm. Një nga kufizimet kryesore për rritje të NMVM-ve është qasja në Financa sepse huadhënësit (institucionet financiare) janë konservatore dhe normat e interesit dhe kërkesat për kolateral mbeten të larta.

Qeveria e Kosovës ka paraqitur një kërkesë në Bankën Botërore për të forcuar ndërmjetësimin e sektorit financiar përmes rritjes së kapitalit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).

NMVM-të në Kosovë ballafaqohen me kufizime të qasjes në financim për shkak të informalitetit të lartë, të drejtave pronësore të paqarta dhe sistemit të dobët gjyqësor, i cili gjithashtu ka shkaktuar praktika konservatore të huadhënies dhe mosrespektim të riskut nga bankat. Të njëjtat arsye i kanë dekurajuar edhe investitorët për të krijuar një skemë private të garancive siç është rasti në shumicën e vendeve në zhvillim. Kjo situatë ka kërkuar ndërhyrje nga sektori publik dhe FKGK u krijua në vitin 2016 si institucion ligjor i pavarur.

Objekti i projektit është përmirësimi i qasjes në financa për NMVM-të, të cilat në të njëjtën kohë janë përfituesit kryesorë së bashku me huadhënësit.

Për shkak të fushëveprimit të projektit, politika e vetme mbrojtëse e aktivizuar është OP 4.01 Vlerësimi Mjedisor dhe kategoria e përgjithshme e Projektit sipas Politikave Mbrojtëse të BB është B. Kjo nënkupton se asnjë aktivitet me rrezik të lartë, nën-projekte të kategorisë A ose të tilla që aktivizojnë politika të masave tjera mbrojtëse të BB nuk do të kualifikohen për mbështetje në kuadër të Projektit. Meqenëse investimet specifike për të cilat do të lëshohen garancitë, sipas Projektit, nuk do të identifikohen deri në implementimin e projektit, është përgatitur kjo Kornizë e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS).

Vlerësimet mjedisore do të kryhen në përputhje me rregulloren mjedisore kombëtare të zbatuar kryesisht nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Politikat Mbrojtëse të BB-së, siç përcaktohet në këtë KMMS.

Procesi i vlerësimit mjedisor kryhet për të përcaktuar ndikimet e mundshme pozitive ose negative të nën-projekteve të propozuara; për të vlerësuar masat paraprake që duhet të ndërmerren për të shmangur, parandaluar, zbutur ose minimizuar ndikimet negative të cilat mund të dëmtojnë mjedisin (për shembull, nëpërmjet masave të ndërtimit dhe zbutjes); dhe për mbikëqyrjen dhe inspektimin e zbatimit të nën-projektit.

Nën-projektet duhet t'i nënshtrohen një procesi të rishikimit mjedisor dhe social nga IFR-të dhe FKGK duke përfshirë procedurat e përshkruara në kapitullin 13. Megjithatë, FKGK do të jetë përgjegjës për zbatimin e suksesshëm të projektit, duke përfshirë pajtueshmërinë e përgjithshme mjedisore. IFR-të do të jenë përgjegjëse për kategorizimin (shqyrtimin) mjedisor të Aplikantëve/nënprojekteve dhe për të siguruar që

secili nënprojekt i garantuar (dhe propozim i nën-projektit) të përfshijë një vlerësim të ndikimit të tij mjedisor të përshtatshëm për kategorinë, masat zbutëse të përshtatshme për rezultatet e vlerësimit dhe dokumentet e pëlqimeve nga autoritetet lokale dhe se nën-projekti është në përputhje me rregullat kombëtare mjedisore dhe politikat mbrojtëse të BB-së.

Qëllimi i KMSM-së është të sigurojë që nën-projektet të cilat mund të zbatohen identifikojnë dhe adresojnë masat për të shmangur dhe minimizuar ndikimet mjedisore dhe sociale në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor dhe social të Kosovës dhe politikat mbrojtëse të Bankës Botërore. KMSM përcakton se si do të merren parasysh dhe aplikohen masat mbrojtëse për të gjitha aktivitetet e projektit që mund të kenë kërkesa për masa mbrojtëse. Ky KMSM është një dokument i FKKG-së që zbatohet për të gjitha aktivitetet e Projektit të Fuqizimit të Sektorit Financiar të Kosovës dhe do të jetë pjesë e domosdoshme e manualit operacional të projektit dhe në marrëveshjen e huasë midis FKKG-së dhe IFR-ve.

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE

Objekti i projektit është përmirësimi i qasjes në IFnancë për NMVM-të dhe përbëhet nga dy komponentë:

Komponenti 1: Avancimi i Kornizës për Garanci Kreditorë (19 milion Euro). Nën këtë komponentë, Projekti do të rrisë bazën e kapitalit të FKKG, duke zgjeruar gamën e produkteve të ofruara. Prandaj, komponenti përbëhet nga dy nënkomponentë:

Nënkomponenti 1: Rritja e bazës së kapitalit të FKKG. Nën këtë nënkomponent, BB do t'i japë hua Republikës së Kosovës 16 milionë dollarë për të zgjeruar bazën e kapitalit të FKKG. MF ka konfirmuar se ata do të jenë pala huamarrëse në emër të FKKG dhe fondet do të kanalizohen si një grant për FKKG-në. Kapitali shtesë do të mundësojë një rritje në përdorimin e Fondit dhe do të lejojë FKKG-në të adresojë një pjesë më të madhe të hendekut të financimit për NVM-të. Vlerësimet e hendekut të financimit dhe konsultimet në ekip me institucionet financiare dhe donatorët e tjerë treguan se ka mjaft hapësirë në sektorin financiar për të absorbuar zgjerimin. Rishikimi i planifikuar nga BQK-ja i koeficientëve të rrezikut për portofolin e garantuar në muajt e ardhshëm pritet të ketë një ndikim pozitiv në kërkesën për garanci.

Nënkomponenti 2: Krijimi i një sporteli për segmente të dobëta dhe strategjike. Sipas këtij nënkomponenti, Banka Botërore do t'i huazojë Republikës së Kosovës 3 deri në 3.5 milion euro për t'u përdorur për kapitalizim të FKKG-së për të siguruar garanci kreditorë të pjesshme dhe nëse është e nevojshme edhe produkte tjera financiare për tema/segmente/sectorë specifikë që kanë rëndësi strategjike për mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë. Këto pritet të përfshijnë sipërmarrësit e rinj, gratë pronare të bizneseve, energjinë e ripërtërishme, menaxhimin e mbeturinave, bujqësinë dhe kolateralin e luajtshëm. Rritja e mbulimit të garancisë është shumë e rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të këtij komponenti pasi që do t'i japë fleksibilitet FKKG-së për të zhvilluar produkte të përshtatura.

Komponenti 2: Zbatimi i projektit dhe forcimi institucional i FKKG (1 milion USD). Nën këtë komponent përafërsisht 500.000 deri në 1.000.000 USD do t'i ofrohen FKKG-së për zbatimin e projektit dhe fuqizimin institucional të cilat do të jenë thelbësore për të përdorur në mënyrë efikase kapitalin shtesë të propozuar.

3 LINJAT E MBËSHKETJES FINANCIARE

3.1 Linja e mbështetjes financiare për investime

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore me kapital të dhuruar në vlerë prej 20 milionë dollarë amerikanë do të:

- Risë bazën e kapitalit të KCGF (në shumën e 16 milion dollarë amerikan),
- Zgjerë gamën e produkteve/sporteve për segmente/sectorë specifik (në shumën e 3 deri 3.5 milion dollarë amerikan), dhe
- Zbatimi i projektit dhe fuqizimi institucional i KCGF (në shumën e 500.000 deri 1.000.000 dollarë amerikanë).

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (KCGF) është një mundësi lokale, e pavarur, e qëndrueshme për garanci kreditore që lëshon garanci të portofolit të kredisë për institucionet financiare për të mbuluar deri në 50% të rrezikut kreditor për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM).

Që një NMVM të kualifikohet për një Garanci Kredie, duhet të plotësohen kushtet minimale në vijim:

- Ndërmarrja, mikro, ndërmarrje e vogël dhe e mesme (NMVM) në pronësi private siç përcaktohet në LKCGF, duhet të jetë e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), të ketë numrin fiskal, të ketë më pak se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar,
- Veprimtaritë e saj afariste nuk duhet të jenë të ndaluara nga legjislacioni në fuqi, dispozitat rregullatore ose traktatet ndërkombëtare në të cilat Kosova është palë,
- Një NMVM kualifikuese duhet të jetë njëqind për qind (100%) në pronësi të qytetarëve privatë ose banorëve të përhershëm të Kosovës, pa pronësi të Qeverisë gjatë periudhës së mbulimit të kredisë nga garancia,
- Një Huamarrës Kualifikues përfshin çdo Palë të Lidhur të atij huamarrësi. Palët e Ndërlidhura duhet të interpretohen në përputhje me Rregulloren e BQK-së për Ekspozimet e Mëdha¹, përkatësisht Nenin 1 paragrafi g) të kësaj Rregulloreje.

Që një Kredi të kualifikohet për Garanci Kreditore, duhet të plotësohen kushtet minimale në vijim:

- Garancitë do të jenë deri në 50% të kryegjësë të kredive për NMVM-të (huadhënësi mund të marrë garanci për një përqindje më të ulët).
- Kredia nuk mund të tejkalojë vlerën maksimale kryesore të përcaktuar në Marrëveshjen e Garancisë.

Madhësia maksimale e një ekspozimi garancie që fondi mund të ketë për një huamarrës ose grup huamarrësish të lidhur do të jetë 250.000 euro. Me fjalë të tjera, ekspozimi maksimal i kredisë që një huadhënës mund të ketë për një huamarrës ose grup huamarrësish të lidhur kur merr pjesë në skemën e garancisë do të jetë 1.000.000 euro.

- Garancitë do të lëshohen vetëm për kryegjënë. Ato nuk do të mbulojnë interesin ose shumat e tjera që janë borxh ose kostot e tjera të shkaktuara nga huadhënësi.
- Maturimi maksimal i kredive që garantohen do të jetë 84 muaj.
- Huadhënësi mund të marrë kolateral nga Huamarrësi, por pritët që shuma e kolateralit do të jetë më e ulët se sa për kreditë pa garanci.

Procesi i pranimit të garancisë

Çdo IFR do të iniciojë, analizojë, zbatojë kujdesin e duhur, do të strukturojë, shpërndajë, menaxhojë dhe zbatojë të gjitha Lehtësimet e Kredive që Kualifikohen në të njëjtën mënyrë siç bën me kreditë e pagarantuara në përputhje të plotë me të gjitha ligjet, rregulloret dhe politikat në fuqi, duke përfshirë ato të BQK-së.

¹ Rregullorja për Ekspozimet e Mëdha e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 26 prill 2013

RFI-të do të vendosin se cilat kredi do t'i dorëzojnë në FKGK për t'u mbuluar me garanci deri në një mbulim maksimal prej 50%. IFR-të do të kryejnë nënshkrimin e kredisë, do të përcaktojnë termat dhe kushtet e kredive, dhe do të dorëzojnë në FKGK huatë që plotësojnë kriteret në Marrëveshjen e Garancisë.

Procesi i dorëzimit

RFI-ja vendosë kreditë e reja nën garanci brenda pesë (5) ditëve të punës nga disbursimi fillestar i huasë, me informacione të tilla si: Institucioni financiar, Detajet e Huasë, Informata për Biznesin e Konsumatorit, Informatat Demografike të Konsumatorit, Informatat për Kolateralin, Informatat për Garantuesin, Informatat për Palën e Lidhur, Informatat për Mjedisin etj. Grupi i plotë i të dhënave që duhet të sigurohen nga IFR-të jepet në Manualin Operativ të MIS të FKGK.

Procesi i aprovimit/pranimimit

Sapo një përdorues IFR dorëzon detajet për kreditë që do të mbulohen nga garancioni, këto kredi paraqiten në MIS si të dorëzuara.

Stafi i emëruar i FKGK-së duhet të sigurojë që informacioni i përpunuar nga përdoruesi IFR është i shëndoshë. Në rast të gabimeve teknike, stafi i emëruar i FKGK-së duhet të kontaktojë IFR-në përkatëse në mënyrë që të korrigjojë gabimet teknike. Sapo stafi i emëruar i FKGK të konsiderojë se informacioni i dhënë është i besueshëm, rasti pranohet në MIS, dhe huaja mbulohet nga FKGK.

Procedurat e shqyrtimit të duhur mjedisor dhe social të përshkruara në Kapitullin 13 plotësojnë procesin e garantimit në baza të barabarta.

3.2 Linja e përkrahjes financiare për ngritjen e kapaciteteve

Nën Komponentin 2 të projektit, FKGK-së do t'i sigurohen fonde për zbatim të projekteve dhe fuqizim institucional të cilat do të jenë thelbësore për të përdorur në mënyrë efikase kapitalin shtesë të propozuar. Nën këtë nënkomponent FKGK do të punësojë ekspertë për (i) të kryer aktivitete të prokurimit dhe menaxhimit financiar për zbatimin e projekteve, (ii) të rishikuar dhe reformuar kornizën legjislative, (ii) përmirësuar teknologjinë e informacionit, (iii) të avancuar vlerësimit e rrezikut, (iv) të përmirësuar kornizën e monitorimit dhe vlerësimit, (v) të dizajnuar dhe zhvilluar produkte të reja të përshtatura për segmentet e nënshërbyera dhe strategjike, (vi) të avancuar kapacitetin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes mjedisore, dhe (vii) të mbështetur fushatën e marketingut dhe ndërgjegjësimit të publikut.

Ngritja e kapaciteteve për menaxhim mjedisor

RFI-të e përfshira kanë kapacitete të ndryshme. Tre banka ndërkombëtare: TEB, Raiffeisen dhe Procredit Bank kanë elaboruar sistemet e menaxhimit mjedisor dhe social – SMMS-të (të paraqitura në Shtojcën 8) dhe/ose mekanizmat për shqyrtimin e huave dhe/ose Aplikuesve për hua dhe sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloren kombëtare mjedisore (dhe të tjerat relevante) ndërsa të tjerat, kryesisht vendore, nuk kanë asnjë. Tre bankat e lartpërmendura me SMMS funksionale do të përdorin sistemet e tyre përveç kësaj KMSM-je për shqyrtimin e projekteve dhe menaxhim. Bankat e tjera të cilat nuk kanë SMMS mund të fillojnë pas fillimit të trajnimit duke mbështetur projektet e kapacitetit C, por do të asistohen nga FKGK dhe BB për të ngritur dhe përmirësuar sistemet gjatë zbatimit të projektit dhe eventualisht më shumë për të mbështetur projekte me më shumë rrezik ndaj mjedisit.

Me qëllim që të sigurohet se procedurat e Vlerësimit Mjedisor (VM), Projekti dhe zbatimi i nën-projekteve janë plotësisht në përputhje me politikat mbrojtëse të BB, është me rëndësi të veçantë që FKGK dhe IFR të kenë kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të zbatuar si duhet këto politika. Në këtë kuptim, FKGK do të kontrakttojë Ekspert Mjedisor (si kusht i efektivitetit të projektit), një anëtar të Ekipit të Zbatimit të Projektit (UZP), me orar të pjesshëm ose të plotë për të siguruar zbatimin e KMSM dhe respektimin e rregulloreve kombëtare të mjedisit dhe politikave mbrojtëse të BB-së nga Projekti. Ekspert Mjedisor do të

ketë përvojë në menaxhimin e mjedisit, vlerësimin e mjedisit dhe të rrezikut dhe do të trajnohet më tej në lidhur me politikat dhe procedurat mbrojtëse të BB-së (nga Specialisti i Mjedisit i BB-së). Nga UA/ajo do të pritet të ofrojë trajnime (të mbështetura nga BB në rastet kur është e nevojshme) për IFR-të, dhe të mbikëqyr performancën e tyre mjedisore gjatë zbatimit.

Të gjitha mangësitë e identifikuar nga IFR-të do të adresohen dhe do të tejkalohen përmes (i) sesioneve trajnuese, përmbajtja e të cilave do të përgatitet nga Eksperti Mjedisor i FKGK dhe aprovohet nga Specialisti i Mjedisit i BB, (ii) udhëzimet, (iii) EMS i ndërtimit, dhe (vi) masat tjera korrigjuese. Programi i trajnimit do të optimizohet bazuar në kapacitetin ekzistues të IFR-ve, reagimet nga IFR-të në fazat e mëvonshme, dhe do të prezantohet nga eksperti mjedisor i angazhuar nga FKGK, i mbështetur nga specialisti i masave mbrojtëse i BB-së, sipas nevojës. Eksperti Mjedisor do t'i raportojë rregullisht BB-së për kapacitetin dhe performancën e IFR-ve në raportet e rregullta të progresit.

4 POLITIKAT E BB TË CILAT ZBATOHEN PËR PROJEKTIN

Politikat mjedisore dhe masat mbrojtëse sociale të BB-së janë të domosdoshme për qëllimet e dyfishta të BB-së për të luftuar varfërinë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët. Objektivi i këtyre politikave është parandalimi dhe zbutja e dëmeve të panevojshme të shkaktuara gjatë procesit të zhvillimit për popullsinë, jetesën e tyre dhe habitatin. Këto politika ofrojnë mbrojtje sociale dhe mjedisore dhe kërkesa e udhëzime të përputhshmërisë për BB-në dhe Huamarrësit/Klientët në identifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e programeve dhe projekteve.

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit mjedisor të Projektit, është aktivizuar vetëm një politikë mbrojtëse e Bankës Botërore, si më poshtë :

- (i) **OP/BP 4.01 (Vlerësimi mjedisor) është aktivizuar.** Kjo politikë aktivizohet për aktivitetet e kualifikuara që mund të mbështeten në kuadër të Komponentit 1, i cili, ndër të tjera, mund të përfshijë sektorë potencialisht ndotës si energjia e rinovueshme, menaxhimi i mbeturinave dhe bujqësia. Aspektet mjedisore përfshijnë ujërat e zeza, prodhimin e mbetjeve, emisionet, punimet në tokë, shëndetin dhe sigurinë në punë, shëndetin e komunitetit dhe më shumë. Pasi që tiparet specifike të projekteve dhe vendndodhja nuk njihen paraprakisht, FKGK ka përgatitur këtë KMSM për të siguruar menaxhim të duhur dhe efikas të mjedisit. Dokumenti KMSM do të ofrojë udhëzime dhe procedura për kujdesin e duhur mjedisor të të gjitha aktiviteteve të projektit të zbatuara nga FKGK, IFR-të dhe përdoruesit përfundimtarë të huave të garantuara. KMSM gjithashtu diferencon dhe përcakton aktivitetet e kualifikuara dhe pakualifikuara/nënprojektet e garantuara në kuadër të Projektit përmes FKGK dhe rrezikut të përjashtimit të përgjithshëm të BB-së (Kapitulli 7) si dhe përjashton nënprojektet e kategorisë A dhe ato aktivitete i nënshtrohen politikave mbrojtëse specifike.
- (ii) Nënprojektet e mbështetura deri më tani nga FKGK-ja kryesisht i përkasin sektorëve si tregtia me shumicë dhe pakicë, shërbimet, produktet e prodhimit, bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe ndërtimi. FKGK do të vazhdojë me këto linja dhe të mos paraqet asnjë kufizim për sektorët e mbështetur, megjithatë, pasi nuk janë aktivizuar politika mbrojtëse specifike ligjore, sociale dhe mjedisore, duke përfshirë: **OP 4.04 (Habitatet Natyrore), OP/BP 4.36 (Pyjet), OP/ BP 4.09 (Menaxhimi i Dëmtuesve), OP/BP 4.11 (Burimet Kulturorë Fizike), OP/BP 4.37 Siguria e Digave, OP/BP 7.50 Projekte në Rrjetet Ndërkombëtare të Ujërave, Masat Mbrojtëse Sociale** që do të thotë se nënprojektet me aktivitete që kërkojnë zbatimin e këtyre politikave nuk do të mbështeten/garantohen në kuadër të këtij Projekti (më shumë detaje në Kapitullin 9 Procedurat e Shqyrtimit).

OP/BP 4.04 (Habitatet natyrore) - Kjo politikë kufizon rreptësisht rrethanat në të cilat cilido projekt i mbështetur nga Banka mund të ndikojë ose ndryshojë habitatet natyrore (tokat dhe ujërat ku shumica e llojeve bimore dhe shtazore janë ende të pranishme) si dhe parqet, zonat natyrore, ose zona të tjera të deklaruara të mbrojtura. Politika nuk aktivizohet që do të thotë se aktivitetet dhe nën-projektet që ndodhin ose mund të ndikojnë në habitatet natyrore, zonat e mbrojtura ose të ndjeshme, ose burimet pyjore ose menaxhimi i tyre nuk kualifikohen për financim.

OP/BP 4.36 (Pyjet) - Politika nuk aktivizohet, prandaj, nënprojektet që përfshijnë menaxhimin e pyjeve, prerjet ose korrjen nuk do të kualifikoheshin për financim.

OP 4.09 (Menaxhimi i dëmtuesve) - Kjo politikë nuk aktivizohet. Projekti nuk do të mbështesë (i) asnjë prokurim të pesticideve ose pajisjeve për aplikimin e pesticideve (përdorimi bujqësor, kontrolli i vektorëve, kontrolli i farërave të këqija, etj.), qoftë drejtpërdrejt nga projekti, ose tërthorazi nëpërmjet huadhënies, bashkëfinancimit ose financimit të qeverisë homologe; (ii) projekte që pritet të prezantojnë praktika të reja të menaxhimit të dëmtuesve, ose të zgjerojnë ose ndryshojnë praktikatat ekzistuese të menaxhimit të dëmtuesve; (iii) çfarëdo projekti ose programi tjetër që mund të çojë në rritjen e konsiderueshme të përdorimit të pesticideve dhe rreziqeve pasuese mjedisore dhe shëndetësore.

OP/BP 4.11 (Burimet kulturore fizike) - Kjo politikë nuk aktivizohet. Çdo punë ose veprimtari të tjera që mund të ndikojnë në burimet kulturore (objekte të luajtshme ose të paluajtshme, lokacione, struktura, grupe të strukturave, dhe karakteristika natyrore dhe peizazhe që kanë rëndësi arkeologjike, paleontologjike, historike, arkitektonike, fetare, estetike ose të tjera kulturore) nuk mund të financohet sipas projektit. Për projektet me veprimtari të lëvizjes së dheut (gërmimi, hapja e kanaleve, shkallëzimi, etj.) kërkohet një procedurë e gjetjes së rastësishme duke përfshirë ndaljen e punimeve dhe njoftimin e autoriteteve kompetente (Ministria e Kulturës) etj. Klauzola e gjetjes së rastësishme në Vlerësimet Mjedisore do të ndjekë procedurat kombëtare.

OP/BP 4.37 (Siguria e digave) - Politika nuk aktivizohet. Natyra dhe kapaciteti i projektit nuk lejon zbatimin e projekteve që përfshijnë diga.

OP/BP 7.50 Projektet për rrugët ujore ndërkombëtare - Politika nuk aktivizohet. Ajo zbatohet për llojet e mëposhtme të projekteve:

(a) Projekte hidroelektrike, të ujitjes, të kontrollit të përmytjeve, të lundrimit, kullimit, ujësjellësit dhe kanalizimit, industriale dhe të ngjashme që përfshijnë përdorimin ose ndotjen e mundshme të rrugëve ujore ndërkombëtare.

(b) Projektim të hollësishëm dhe studime inxhinierike të projekteve.

Të gjithë lumenjtë kryesorë të Kosovës (prandaj edhe degët e tyre) janë ndërkufitare, por duke pasur parasysh natyrën e nënprojekteve potenciale, nuk pritet që kjo politikë të zbatohet. Shqyrtimi do të përjashtojë çdo projekt që potencialisht mund të aktivizojë këtë politikë.

OP/BP 4.12 (Risistemimi i pavullnetshëm) -Përvetësimi i pavullnetshëm i tokës dhe/ose risistemimi nuk do të jenë të pranueshme sipas projektit të propozuar. Gjatë procedurave të shqyrtimit, nëse të gjeturat tregojnë se nënprojekti përfshin marrjen e pavullnetshme të tokës dhe/ose risistemimin e pavullnetshëm, duke përfshirë heqjen e pavullnetshme të personave të cilët nuk kanë të drejtë ligjore ose pretendime të njohura për tokën/pronën e prekur, nënprojekti i propozuar nuk do të kualifikohet për financim në kuadër të projektit. Shitja vullnetare

(transaksionet ku ka blerës të vullnetshëm e shitës të vullnetshëm) të tokës dhe pronave të kërkuara për të realizuar planet e NMVM nuk bien në marrjen e pavullnetshme të tokës.

(iii) Vetëm aktivitetet e kategorisë B dhe C do të mbështeten (garantohen) në kuadër të Projektit.

5 HISEDARËT

Në kontekstin e zbatimit të këtij projekti ekzistojnë tre hisedarë: (i) FKGK që zbaton projektin duke përdorur këto fonde; (ii) IFR-të - Bankat ndërkombëtare dhe lokale, përfituesit e garancive të FKGK-së, (iii) përdoruesit përfundimtarë (NMVM-të/Aplikuesit) si përfitues të drejtpërdrejtë.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (KCGF) është themeluar në janar 2016 për të ofruar garanci për bizneset e ligjshme rezidente në Kosovë. FKGK është krijuar për të ndihmuar në plotësimin e nevojës për qasje më të madhe në financa për NMVM-të në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimeve vendore dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, përmirësimit të bilancit tregtar dhe rritjes së mundësive të financimit për NMVM-të. FKGK u lëshon garanci institucioneve financiare për të mbuluar rrezikun për huatë e NMVM-ve. Pra, FKGK ndihmon institucionet financiare t'u japin hua NMVM-ve që janë të qëndrueshme, por nuk kanë kolateral të mjaftueshëm dhe/ose histori kreditimi; NMVM-të që kanë nevojë për financim afatgjatë; NMVM-të që mund të rrisin prodhimin lokal dhe të ulin importet dhe/ose të rrisin eksportet; NMVM-të në pronësi të grave; dhe NMVM-të që do të krijojnë vende të reja pune. FKGK ka 5 punonjës dhe asnjë me përvojë ose trajnim për çështjet mjedisore, prandaj kapaciteti i FKGK për menaxhim mjedisor vlerësohet i kufizuar.

Hisedarët mjedisor

Dy institucionet kryesore hartojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e legjislaturës dhe rregulloreve mjedisore në Kosovë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM).

MMPH është organ qendror ekzekutiv i ngarkuar me krijimin dhe zbatimin e legjislacionit të përgjithshëm të menaxhimit në fushën e mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor të banimit dhe ndërtimit.

AKMM është institucion qeveritar që përmes monitorimit të integruar mjedisor, sistemit efikas të informacionit mjedisor dhe raportimit të vazhdueshëm mbi situatën mjedisore, angazhohet në ruajtjen e cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, promovon përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore².

MMPH lëshon leje për menaxhimin e mbeturinave, leje për eksport, import dhe transit të mbeturinave dhe menaxhon mbeturinat e rrezikshme. Sa i përket licencave për administrimin e deponive të mbeturinave, një ose më shumë komuna, me marrëveshje, mund të përcaktojnë dhe përdorin lokacionin në territorin e tyre për ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve për menaxhimin e mbeturinave. Nëse komunat nuk mund të arrijnë marrëveshje për caktimin e një vendi të përbashkët për menaxhimin e mbeturinave, vendimi do të merret nga MMPH në bazë të kushteve të përmbushura, sipas këtij ligji.

Qeverisjet vendore (komunat) janë përgjegjëse për lëshimin e planeve lokale për menaxhimin e mbetjeve, përcaktimin e lokacioneve për nevojat e menaxhimit të mbeturinave komunale, etj., sipas planit hapësinor dhe përcaktimin e taksave për grumbullimin dhe asgjësimin e mbeturinave komunale. Sipas Ligjit, ato janë gjithashtu përgjegjëse për përzgjedhjen e personave të licencuar (përmes zbatimit të procedurave të prokurimit) për grumbullimin, mbledhjen, ruajtjen dhe transportimin e mbeturinave të ngurta,

² <http://www.ammk-rks.net/?page=2,46>

mbeturinave komunale, voluminoze, nga ndërtimi dhe prishja e ndërtesave dhe ndërtesave komerciale brenda territorit të tyre. Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KLMC) menaxhon deponitë sanitare të mbeturinave komunale.

6 PASQYRA E LEGJISLACIONIT KOMBËTAR

Ligji për Mbrojtjen Mjedisore 03/L-025 është pjesë qendrore e kornizës ligjore dhe rregullatore për mjedisin në Kosovë. Qëllimi themelor i këtij ligji është krijimi i një kornize ligjore bazë që do të promovojë një mjedis gjithnjë e më të shëndetshëm për popullin e Kosovës përmes përfshirjes graduale të Standardeve Mjedisore të Bashkimit Evropian. Ligji adreson parandalimin dhe uljen e ndotjes, monitorimin e mjedisit dhe nxjerr në pah, ndër të tjera, parimet e përdorimit racional të burimeve natyrore.

Ky ligj përcakton se vlerësimi i ndikimit në mjedis do të bëhet për projektet e planifikuara dhe të realizuara në vend, duke përfshirë ndryshimet në teknologji, rindërtimin dhe shtrirjen e objekteve ose ndërprerjen e veprimeve, të cilat mund të rezultojnë me ndotje të madhe mjedisore ose që përbëjnë rrezikun për shëndetin e njerëzve.

Ligji Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis rregullon procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar, me qëllim që gjatë procesit të vendimmarrjes nga MMPH për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor, të ofrohen të gjitha informatat relevante në lidhje me mjedisin.

Aktivitetet e detyrueshme të VNM-së janë të listuara në Shtojcën I të Ligjit ndërsa Shtojca II liston aktivitetet për të cilat MMPH vendos sipas kërkesave të VNM-së. **Asnjë projekt i tillë, që kërkon VNM sipas legjislacionit kombëtar, nuk do të mbështetet me këtë Projekt.**

Zonat e mbrojtura natyrore qeverisen nga drejtoritë, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2010/03-L-233). Drejtoritë për menaxhimin e parqeve kombëtare, parqeve natyrore, monumenteve natyrore me rëndësi të veçantë themelohen nga MMPH, ndërsa kategoritë e tjera të zonave të mbrojtura drejtohen nga autoritetet e themeluara nga komuna. **Autorizimi për ndërhyrje dhe veprimtari në zona rreptësisht të mbrojtura, zona të veçanta, parqe kombëtare, parqe natyrore, monumente të natyrës, lëshohet nga Ministria. Autorizimi për punime dhe ndërhyrjet në peizazh dhe monumente të mbrojtura të arkitekturës së parqeve, lëshohet nga autoriteti administrativ ose autoriteti kompetent komunal. Autorizimi lëshohet me vendim.** Ankesat ndaj vendimit të organit administrativ ose të autoritetit kompetent komunal mund të dorëzohen në Ministri..

Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit rregullon parimet, organizimin dhe mbikëqyrjen inspektuese, koordinimin e inspektimit mbikëqyrës, të drejtat, detyrat, kompetencat e inspektorëve, të drejtat, obligimet dhe subjektet mbikëqyrëse, procedurën për kryerjen e inspektimit dhe çështje të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese. Fushëveprimi i këtij ligji merret me detyrat dhe kompetencat e inspektorëve sipas mbikëqyrjes së fushave mjedisore, ujit, natyrës, planifikimit urban dhe ndërtimit brenda organeve të nivelit lokal dhe qendror duke përfshirë Inspektoratin Komunal për Ndërtim dhe Inspektoratin Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit.

Ligji për Ndërtim Nr. 2004/2015 përcakton kërkesat kryesore për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e materialeve ndërtimore, mbikëqyrjen profesionale, si dhe procedurat për lejet e ndërtimit, lejet e përdorimit dhe inspektimin e ndërtimit. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë kushtet e projektimit dhe ndërtimit në lidhje me sigurinë publike dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë dhe ato janë gjithashtu të

zbatueshme për objekte të tjera ndërtimore, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me udhëzim administrativ³.

Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Qëllimi i këtij ligji është vendosja e masave për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë. UA rregullon kushtet e punës në një vend pune, të drejtat e punonjësve dhe detyrimet e punëdhënësit, në përgjithësi. Sipas këtij ligji, punëdhënësi që punëson deri në pesëdhjetë (50) punonjës, nëse është kompetent, mund të marrë personalisht përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara me këtë ligj; Punëdhënësi që punëson mbi pesëdhjetë (50) punonjës dhe më pak se dyqind e pesëdhjetë (250) punonjës, është i detyruar të emërojë një ekspert për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë; Punëdhënësi që punëson mbi dyqind e pesëdhjetë (250) punonjës duhet të angazhojë një (1) ose më shumë ekspertë për të kryer aktivitete që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. **Sipas këtij ligji, të gjithë NMVM-të që punësojnë më shumë se 50 dhe më pak se 200 punonjës janë të detyruara të emërojnë një ekspert për shëndetin dhe sigurinë.**

Ligji për Mbeturinat (2012), Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plani Pesëvjeçar për Menaxhimin e Mbeturinave (2013-2017) me veprimet e bazuara në Strategji përbëjnë thelbin e legjislaturës së Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta(MMN). Sipas këtij legjislacioni, Kosova ka krijuar një sistem rajonal të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Kohët e fundit, ka filluar ndryshimet në sistemin e faturimit dhe grumbullimit që synojnë të përmirësojnë performancën financiare të sektorit⁴. Mbeturinat e rrezikshme menaxhohen sipas dispozitave të Ligjit për Mbeturinat dhe UA-ve përkatëse (si: UA nr.22/2015 për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë asbest, UA Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave të produkteve mjekësore, UA Nr.15/2015 për menaxhimin e mbeturinave të tubave fluoreshentë që përmbajnë merkur, UA nr. 07/2014 për kompetencat e mbajtësit të mbeturinave, prodhuesit dhe importuesit e produkteve, etj.), respektivisht MMPH ka mandatin për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse. Masat që duhet të ndërmerren për mbeturinat e rrezikshme janë elaboruar nga Strategjia Kombëtare 5 vjeçare për Menaxhimin e Mbeturinave.

Qëllimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 është të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë në bazë të prioritetëve, efektet e dëmshme, duke përfshirë shqetësimin, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës, në mjedis.

Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe asaj që ka të bëjë me Projektin, çdo ndërhyrje që mund të ndikojë në integritetin ose vlerat e trashëgimisë kulturore kërkon leje me shkrim nga Institucioni kompetent. Institucioni kompetent do të urdhërojë ndalimin e menjëhershëm për një periudhë të papërcaktuar kohore të çdo lloj pune të paautorizuar në Trashëgiminë Kulturore. Nëse gjatë punëve ndërtimore bëhet ndonjë zbulim arkeologjik, zbuluesi ose investitori informon menjëherë Institucionin kompetent, por jo më vonë se një ditë pas nga momenti i zbulimit. Institucioni kompetent ka të drejtë të ndërpresë menjëherë punimet zhvillimore të nisura dhe do të ndërmarrë një studim vlerësues dhe të shpëtojë arkeologjinë në vend për një periudhë të kufizuar kohore që do të përcaktohet me një akt nënligjor në bazë të këtij ligji. Punët zhvillimore mund të rifillojnë vetëm pas lejes së shprehur me shkrim nga Institucioni kompetent.

³³ http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2004regs/RE2004_37_ALE2004_15.pdf

⁴ <http://documents.worldbank.org/curated/en/282091494340650708/pdf/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf>

7 INVESTIMET QË KUALIFIKOHEN DHE QË NUK KUALIFIKOHEN

7.1 Aktivitetet që janë përjashtuar nga KCGF

Politikat e brendshme të FKGG-së për Garancinë e rrezikut Kreditor përkufizojnë sektorët e ndaluar dhe qëllimet e huave të cilat nuk mund të përkrahen në kuadër të Projektit:

- Puna e detyruar⁵ ose puna nga fëmijët⁶.
- Aktivitetet ose materialet që konsiderohen të paligjshme sipas ligjeve ose rregulloreve të vendit pritës ose konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ose atyre që janë subjekt i largimit në faza ose ndalimeve ndërkombëtare, si:
 - Substancat që zvogëlojnë ozonin, PCB-të (Bifenilet e poliklorinuara) dhe produktet tjera specifike, të rrezikshme, pesticidet/herbicidet ose kimikatat;
 - Kafshët e egra ose produkte e rregulluara sipas Konventës mbi tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara ose faunës dhe florës së egër (CITES); ose
 - Metodatat e paqëndrueshme të peshkimit (p.sh., peshkimi me shpërthim dhe peshkimi me rrjeta të mëdha në mjedisin detar duke përdorur rrjeta që tejkalojnë 2.5 km gjatësi).
 - Tregtia ndërkufitare e mbeturinave dhe produkteve të mbetjeve, përveç nëse është në përputhje me Konventën e Bazelit dhe me rregullat themelore.
 - Shkatërrimi i zonave me vlera të larta konservimi⁷
 - Materialet radioaktive⁸ dhe fibrat e asbestit të palidhur.
 - Pornografia dhe/ose prostitucioni. 10. mediati raciste dhe/ose anti-demokratike.
 - Në rast se ndonjë nga produktet e mëposhtme përbën një pjesë thelbësore të aktiviteteve primare të biznesit të projektit⁹:
 - Pijet alkoolike (përveç birrës dhe verës);
 - Duhani;
 - Armët dhe municionet; ose
 - Bixhozi, kazinotë dhe ndërmarrjet ekuivalente

7.2 Përjashtimet nga politikat e BB

Nga kredia e BB-së nuk është e mundur të financohen projekte të kategorisë A dhe me rrezik të lartë, projekte që aktivizojnë politika specifike mbrojtëse të BB-së, si dhe aktivitetet e mëposhtme, siç përcaktohet në listën e përjashtimeve të përgjithshme të BB-së:

- Tregtimi i kafshëve të egra dhe produkteve të kafshëve të egra të ndaluara sipas konventës CITES,
- Lirimi i organizmave të ndryshuar gjenetiksht në mjedisin natyror,

⁵ Punë e detyruar nënkupton të gjitha punët ose shërbimet që nuk kryhen vullnetarisht, të marra nga një individ nën kërcënimin e forcës ose dënimit siç përcaktohet nga konventat e ONP

⁶ Personat mund të punësohen vetëm nëse janë të paktën 14 vjeç, siç përcaktohet në Konventat Themelore të të Drejtave të Njeriut të ONP (Konventa për moshën minimale C138, Neni 2), përveç nëse legjislacioni vendor shprehimisht përcakton vijimin e detyrueshëm të shkollës ose moshën minimale të punës. Në ato raste aplikohet kufiri i sipërm.

⁷ Shkatërrimi nënkupton (1) eliminimin ose zvogëlimin e ndjeshëm të integritetit të një zone të shkakuar nga një ndryshim i madh afatgjatë në shfrytëzimin e tokës ose ujit ose (2) modifikimin e habitatit në mënyrë të tillë që aftësia e zonës për të ruajtur rolin e saj është humbur. Vlerat e Larta të Konservimit (HCV) përcaktohen si habitate natyrore ku këto vlera konsiderohen të jenë me rëndësi të madhe ose me rëndësi kritike (shih <http://www.hcvnetwork.org>).

⁸ Kjo nuk vlen për blerjen e pajisjeve mjekësore, pajisjeve të kontrollit të cilësisë (matjes) ose ndonjë pajisje tjetër ku burimi radioaktiv kuptohet të jetë i parëndësishëm dhe/ose i mbrojtur në mënyrë adekuate

⁹ Për kompanitë, "e konsiderueshme" do të thotë më shumë se 10% e bilancit të tyre të konsoliduar ose të ardhurave. Për institucionet financiare dhe fondet e investimeve, "e konsiderueshme" do të thotë më shumë se 10% e vëllimeve të tyre të portofolit.

- Prodhimi, shpërndarja dhe shitja e pesticideve dhe herbicideve të ndaluara,
- Peshkimi me rrjeta të mëdha në mjedisin detar,
- Prodhimi, trajtimi dhe asgjësimi i produkteve radioaktive,
- Magazinimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme,
- Prodhimi i pajisjeve dhe aparateve që përmbajnë CFC, halon dhe substanca të tjera të rregulluara sipas Protokollit të Montrealit,
- Prodhimi i pajisjeve elektrike që përmbajnë bifenile të poliklorinuara (PCB) që tejkalojnë 0,005% të peshës,
- Prodhimi i produkteve që përmbajnë asbest,
- Reaktorët bërthamorë dhe pjesët e tyre,
- Duhani, i fabrikuar dhe i pafabrikuar,
- Makineritë e përpunimit të duhanit, dhe
- Prodhimi i armëve të zjarrit.

7.3 Llojet e tjera të projekteve që nuk kualifikohen

- Përveç nga BB-ja, politika OP/BB 4.01 Vlerësimi i Mjedisit mund të aktivizohet edhe nga nën-projekti. Në rast se aktivizohet ndonjë politikë tjetër mbrojtëse e BB-së, do të përjashtohet nga financimi. Në terma praktikë kjo nënkupton se të gjitha nënprojektet me ndikim të mundshëm në: pyjet, trashëgiminë kulturore, përdorimin e pesticideve, ujërat dhe sigurinë e digave do të refuzohen në kuadër të Projektit.
- Projektet me rrezik të lartë të kategorizuar nga IFR-të që kërkojnë çfarëdo lloj ndërtimi ose zgjerim të kapacitetit
- Të gjitha aktivitetet e renditura në Shtojcën 1 të Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për të cilat VNM është i detyrueshëm sipas rregullores kombëtare.
- Të gjitha aktivitetet e renditura në Shtojcën 2 të Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për të cilat kërkohet VNM nga autoriteti kompetent.

8 VLERËSIMI MJEDISOR DHE KATEGORITË E SHQYRTIMIT

8.1 Kërkesat e rregullores për VNM të Kosovës

Sipas *Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Ligji Nr. 03/L-214)*, Pëlqimi Mjedisor kërkohet për çdo projekt publik ose privat të renditur në Shtojcën I ose Shtojcën II të këtij Ligji (shih Shtojcën 6 dhe Shtojcën 7 të KMSM), që ka të ngjarë të ketë efekte të rëndësishme në mjedis nëpërmjet virtytit, *inter alia*, të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes së tij. Të gjitha projektet e listuara në Shtojcën I duhet t'i nënshtrohen VNM-së, ndërsa Projektet e renditura në Shtojcën II shqyrtohen rast pas rasti dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Shtojcën III të ligjit për VNM, me qëllim të përcaktimit nëse kërkohet që ato t'i nënshtrohen VNM-së. Sipas këtij Ligji, procedura e VNM përfshin fazat e mëposhtme: (1) përzgjedhja; (2) caktimi i fushëveprimit; (3) shqyrtimi i Raportit të VNM-së. Mund të garantohen vetëm nënprojektet që nuk kërkojnë VNM sipas këtij legjislacioni.

Përzgjedhja (shqyrtimi i përmbushjes së kriterëve)

Bazuar në informatat e marra (pyetësi i plotësuar, i përcaktuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), që mbulon përshkrimin e projektit të propozuar, përshkrimin e vendndodhjes dhe përshkrimin e ndikimeve të mundshme mjedisore të projektit të propozuar), të paraqitura së bashku me kërkesën dhe në bazë të kriterëve të paraqitura në Shtojcën III, MMPH përcakton nëse projekti i propozuar ka të ngjarë të ketë efekte domethënëse në mjedis dhe brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e pranimit të aplikacionit, njofton me shkrim aplikuesin për vendimin e saj nëse kërkohet apo jo Raporti i VNM-së. Nëse

nuk kërkohet raport i VNM-së, komuna përkatëse vlerëson projektin sipas kërkesave të lejes komunale dhe mund të fillojë procedurën për lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale.

Leja Mjedisore Komunale

Projektet dhe aktivitetet që i nënshtrohen Lejeve Mjedisore Komunale (LMK) janë të listuara në Shtojcën e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 (shih Shtojcën 7 të KMSM) si dhe projektet dhe aktivitetet që kanë kaluar fazën e përzgjedhjes në MMPH dhe vlerësohen se i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale dhe jo të VNM-së.

Për marrjen e lejes mjedisore komunale, që është kusht për marrjen e lejes së ndërtimit dhe zhvillimin e aktiviteteve specifike, aplikanti duhet të paraqesë një kërkesë në komunë në të cilën është bashkangjitur raporti mbi LMK-në. LMK-ja lëshohet pas shqyrtimit dhe miratimit të Raportit.

Raporti për LMK-në përmban:

- Përshkrimin e projektit;
- Përshkrimin e procesit teknologjik, pajisjeve të përditësuara;
- Identifikimin dhe përshkrimin e ndikimeve mjedisore;
- Përshkrimin e masave për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis;
- Vlerat e investimeve të projektit;
- Masat për rehabilitimin e sipërfaqes pas përfundimit të aktivitetit

Raporti mund të hartohet nga një person fizik ose juridik, i cili së bashku me aplikuesin për Raport të LMK-së është përgjegjës për saktësinë e të dhënave që përmban Raporti.

Udhëzimi Administrativ për dhënien e LMK është në fuqi që nga viti 2017, kështu që subjektet ekzistuese, që nuk kanë LMK, janë të obliguara të pajisen me LMK.

Autorizimi Mjedisor

Autoriteti kompetent për zbatimin e procedurave për lëshimin e këtij autorizimi është MMPH. Autorizimi mjedisor kërkohet për:

- Aktivitete dhe projekte të përkohshme të propozuara, të cilat mund të shkaktojnë ndikime në mjedis.
- Projekte të përkohshme të propozuara për të cilat nuk kërkohet Pëlqim Mjedisor dhe Pëlqim Mjedisor Komunal (p.sh., transportimi i materialeve të rrezikshme).

Për të marrë një Autorizim Mjedisor, aplikanti duhet të dorëzojë Aplikacionin në MMPH duke ia bashkangjitur një Raport Mjedisor. Ky raport, i cili duhet të hartohet nga aplikanti, përmban:

- Përshkrimin e projektit ose aktivitetit,
- Përshkrimin e pajisjeve dhe procesit të projektit ose aktiviteteve,
- Identifikimin dhe përshkrimin e ndikimeve mjedisore.

8.2 Kategoritë e shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve mjedisore të BB

Varësisht prej llojit, vendndodhjes, ndjeshmërisë dhe shkallës së projektit dhe natyrës e madhësisë së ndikimeve të mundshme mjedisore, nën-projekti mund të klasifikohet në një nga katër kategoritë:

Kategoria A

Aktivitetet e Kategorisë A nuk do të financohen përmes skemës së nën-huave

Një nënprojekt i propozuar klasifikohet në këtë kategori, nëse ka të ngjarë të ketë ndikime me rëndësi të madhe, të ndryshme dhe/ose të pafavorshme në afat të gjatë në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin natyror, madhësia e të cilave është vështirë të përcaktohet në fazën e identifikimit të nën-projektit. Këto ndikime mund të prekin gjithashtu një zonë më të gjerë se sa lokacioni i nën-projektit. Masat për zbutjen e rreziqeve të tilla mjedisore mund të jenë komplekse dhe të kushtueshme.

Për këtë arsye kërkohet një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e ardhshme mjedisore që lidhen me projektin e propozuar, për të identifikuar mundësitë e mundshme të përmirësimit të mjedisit dhe për të rekomanduar çfarëdo mase të nevojshme për të parandaluar, minimizuar dhe zbutur ndikimet e padëshiruara.

Aplikuesi është përgjegjës për përgatitjen e një raporti, normalisht një VNM. Aplikuesi paralelisht duhet të sigurojë studimin e fizibilitetit ekonomik të nënprojektit. Kostot e masave zbutëse do të përfshihen në VNM dhe përfshihen në studimin e fizibilitetit.

Për projektet e kategorisë A, studimi i ndikimit në mjedis është përcaktuar nga ligji i VNM i Republikës së Kosovës. Ligji i VNM-së identifikon projektet për të cilat, sipas rregullores së Kosovës, është e detyrueshme VNM-ja (Shtojca I e Ligjit të VNM-së).

Projektet e Kategorisë A (Shtojca I e Ligjit të VNM-së) dhe projektet me rrezik të lartë (nënprojektet nga Shtojca II e Ligjit të VNM-së nga të cilat MMPH kërkon VNM) nuk do të mbështeten (financohen apo garantohen) në kuadër të këtij Projekti.

Kategoria B

Një projekt i propozuar klasifikohet si Kategoria B nëse ndikimet e tij të pafavorshme mjedisore në njerëz ose në mjedis janë më pak të dëmshme se ato të projekteve të Kategorisë A. Këto ndikime janë specifike për nga vendi; pak prej tyre, nëse ka të tillë, janë të pakthyeshmë; dhe në shumicën e rasteve masat zbutëse mund të dizajnohen më lehtë se sa për projektet e Kategorisë A. Shtrirja e VM për një projekt të kategorisë B mund të ndryshojë nga nënprojekti në nënprojekt. Ashtu si VM për Kategorinë A, shqyrton ndikimet e mundshme negative dhe pozitive mjedisore të projektit dhe rekomandon çfarëdo mase të nevojshme për të parandaluar, minimizuar, zvogëluar ose kompensuar ndikimet negative dhe për të përmirësuar performancën mjedisore. Vlerësimet mjedisore për këto projekte kryhen nga Aplikuesit dhe shqyrtohen dhe miratohen nga IFR-të, ex-ante. Asnjë punim dhe aktivitet projektues që mund të shkaktojë efekte negative mjedisore nuk lejohet para se të finalizohet raporti i Vlerësimit Mjedisor (që përmban planin e menaxhimit dhe monitorimit).

Për qëllime të këtij projekti, duke marrë parasysh specifikat e tij, dallohen dy nën-kategori B:

Kategoria B-

Kategoria B- përfshin nën-projekte që përfshijnë përmirësime të thjeshta, punime të vogla civile, ndërtime të vogla (p.sh. anekset e vogla të ndërtesave ekzistuese dhe objekte të vogla mbështetëse, ndërtime të thjeshta, por jo projekte të reja të mëdha "greenfield"), si dhe rindërtim, rehabilitim ose përshtatje të ndërtesave ekzistuese. Për projekte të tilla, është përgatitur dhe konsultuar publikisht një listë kontrolluese e PMMS për kategorinë B- (shih Shtojcën 2) si pjesë e kësaj KMSM. Lista kontrolluese e PMMS për kategorinë B- do të shpërndahet nga IFR-të të Aplikuesit/Kontraktorët për nënprojektet e kategorizuara si B1 dhe do të aplikohet gjatë implementimit. Aplikuesi është përgjegjës për implementimin e listës kontrolluese të PMMS dhe respektimin e rregulloreve kombëtare. Lista

kontrolluese e PMMS-së do të jetë pjesë e ofertave dhe dokumenteve kontraktuese me kontraktuesit e punëve nëse është e aplikueshme. Aplikuesi dhe/ose Kontraktori i Aplikuesit janë përgjegjës për zbatimin e Listës kontrolluese të PMMS. Këto do të kontrollohet sipas rastit nga IFR, FK GK dhe ndoshta BB. Në kushte të jashtëzakonshme projekte të tjera mund të bien në Kategorinë B+.

Kategoria B+

Kategoria B + përfshin nën-projektet që janë të listuara në Shtojcën II të Ligjit për VNM të Kosovës për të cilat nuk kërkohet VNM e plotë sipas opinionit të MMPH. Për këto nënprojekte, do të përgatitet Raporti i Shqyrtimi i përmbushjes së kriterëve i cili përfshin PMMS (shtojca 3) bazuar në opinionin/vendimin e shkruar të MMPH-së se VNM-ja nuk është e nevojshme. Për këtë lloj të punëve PMMS-ja do të publikohet dhe konsultohet publikisht në faqen e internetit të Ministrisë ose Komunës, ose në faqen e internetit dhe në tabelën informuese të aplikuesit. Nëse kërkohet, Leja Mjedisore Komunale do të publikohet gjithashtu. Në kushte të jashtëzakonshme projekte të tjera mund të bien në kategorinë A.

Kategoria C

Një projekt i propozuar klasifikohet në Kategorinë C nëse:

- (i) ka të ngjarë të ketë ndikime minimale ose të mos ketë fare ndikime të dëmshme mjedisore dhe prandaj nuk kërkohet as Vlerësim Mjedisor;
- (ii) Të gjitha nën-projektet e tjera. Në këto raste, sistemi mjedisor i Bankave (RFI) do të përdoret për të menaxhuar rreziqet mjedisore dhe SHSP-të. Këto projekte mund të përfshijnë nevojën për autorizim mjedisor.

Përtej shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve, nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm i VM për një projekt të kategorisë C.




Figura 1 Kualifikueshmëria dhe kujdesi i duhur¹⁰

- (1) ¹⁰ Tregtimi i kafshëve të egra dhe produkteve të kafshëve të egra të ndaluara sipas konventës CITES; b) Lirimi i organizmave të ndryshuar gjenetikisht në mjedisin natyror; c) Prodhimi, shpërndarja dhe shitja e pesticideve dhe herbicideve të ndaluara; d) Peshkimi me rrjeta të mëdha në mjedisin detar; e) Prodhimi, trajtimi dhe asgjësimi i produkteve radioaktive; f) Magazinimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme; g) Prodhimi i pajisjeve dhe aparateve që përmbajnë CFC, halon dhe substanca të tjera të rregulluara sipas Protokollit të Montrealit; h) Prodhimi i pajisjeve elektrike që përmbajnë bifenile të poliklorinuara (PCB) që tejkalojnë 0,005% të peshës; i) Prodhimi i produkteve që përmbajnë asbest; j) Reaktorët bërthamorë dhe pjesët e tyre; k) Duhani, i fabrikuar dhe i pafabrikuar; l) makineritë e përpunimit të duhanit, dhe m) Prodhimi i armëve të zjarrit . Përveç kësaj, nuk lejohet blerje e pesticideve; nuk lejohen punime në vendet e trashëgimisë kulturore dhe projektet me rrezik të lartë të klasifikuar nga RFI-të (ndërtimi dhe zgjerimi i kapacitetit)
- (2) ESMP – Plani i menaxhimit mjedisor dhe social është pjesë e dokumentit të shqyrtimit të përmbushjes së kritereve i përgatitur për opinion mbi nevojën për VNM
- (3) Shpalosja ndaj publikut dhe konsultimi do të bëhen në bazë të dokumentit të shqyrtimit të përmbushjes së kritereve /ESMP sipas legjislacionit kombëtar, nëse dështon, do të bëhet nga investitori
- (4) Lista kontrolluese e ESMP-së është një listë e përgjithshme e ESMF-së për punimet e vogla ndërtimore e përgatitur si pjesë e ESMF të projektit
- (5) Lista kontrolluese e ESMP-së shpaloset dhe konsultohet si pjesë e dokumentit të ESMF-së. Nëse është kompani më e madhe, ata mund ta shpalosin në faqen e tyre të internetit ose tabelën e informatave
- (6) Projekti i Kategorisë C përfshin: a) Veturat; b) Automjetet komerciale; c) Pajisje të tjera; d) Pajisje prodhimi ose bujqësore; e) kapital qarkullues; f) Renovimi (brenda objektit); g) blerjen e tokës dhe ndërtesave. Mund të kërkohet autorizimi mjedisor

Shembuj të kategorizimeve të sakta bazuar në nënprojektet më të zakonshme të NMVM-ve që aplikojnë për kredi në tre IFR-të e përzgjedhura janë paraqitur në tabelë:

Destinimi i kredisë	Kategoria
Automobila	C
Vetura komerciale	C
Pajisje tjera	C
Pajisje prodhimi ose bujqësie	C
Kapital punues	C
Ndërtim ose renovim	C ose B -
Blerje e tokës dhe ndërtesave	C
Tjera	C, B- ose B+
Totali	

8.3 Dokumentet për kujdesin e duhur mjedisor

RFI-të duhet të përfshijnë pakot e mëposhtme të dokumenteve të garancionit mjedisor (Tabela 1):

Tabela 1: Dokumentet mjedisore

Kategoria mjedisore	Dokumentet mjedisore për tu përfshirë në pakon e aplikimit për nën-hua
Kategoria C	Pyetësori mjedisor
Kategoria B-	Pyetësori mjedisor Cilido aprovim/leje zyrtare (nëse zbatohet) Lista kontrolluese e PMMS për kategorinë B-
Kategoria B+	Formulari shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve mjedisore dhe pyetësori mjedisor Vendimi i MMPH për VNM Cilido aprovim/leje zyrtare (nëse zbatohet) PMMS për kategorinë B+

8.4 Auditimi mjedisor (Raporti)

Auditimi mjedisor do të kryhet si pjesë e procedurave të rregullta të auditimit të FKGK-së në rastin kur aktivizohet një garanci. Auditimi do të kryhet kundrejt rregullores kombëtare mjedisore, politikave mbrojtëse të BB-së dhe dokumenteve të kujdesit të duhur mjedisor për nën-projektin (KMSM dhe VM të përshtatshme për kategorinë e nën-projektit). Rezultatet do të komunikohen në Raportin e Detajuar të Auditimit Mjedisor. Për të gjitha nën-projektet e kategorisë B, përcaktimi i mospërputhshmërisë domethënëse gjatë auditimit mund të çojë në anulimin e garancisë, sipas ekspertit mjedisor IFR (në marrëveshje me ekspertin e FKGK).

9 PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE

Vlerësimet mjedisore do të kryhen në përputhje me Rregulloren për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të Kosovës dhe (OP 4.01) e BB për Vlerësimin Mjedisor.

Si hap i parë i shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve, IFR-të duhet të identifikojnë dhe refuzojnë llojet e mëposhtme të propozimeve për nën-projekte, si të pakualifikuara për financim në kuadër të këtij projekti:

- (a) në qoftë se është një projekt i Kategorisë A, sipas Kategorizimit të BB (OP 4.01) dhe Shtojcës I ose aktivitet i listuar në Shtojcën II për të cilin MMPH kërkon VNM sipas Ligjit të Kosovës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- (b) nëse nënprojekti është në listën e përjashtimeve të BB ose FKGK (shih kapitullin 7 të këtij KMSM);
- (c) nëse nënprojekti aktivizon politikën e BB për Habitatet Natyrore (OP/BP 4.04, gjegjësisht vendndodhja e projektit është në një vend të mbrojtur natyror, ose aktivitetet e projektit do të rezultojnë me ndikime në habitatet natyrore (habitate kritike dhe jo kritike);
- (d) nëse nënprojekti aktivizon politikën e BB për menaxhimin e dëmtuesve (OP 4.09); nëse shkakton ndonjë ndryshim në menaxhimin e dëmtuesve, p.sh. zgjerim i prodhimit bujqësor, ndryshim i kulturave bujqësore ose teknikave bujqësore, përfshirje të kontrolleve të reja të dëmtuesve, në disa raste ndërtimi apo zgjerimi i prodhimit apo magazinimit të ushqimit (që kërkon menaxhim të dëmtuesve, p.sh. gruri);
- (e) nëse nënprojektet aktivizojnë politikën e BB për Burimet Fizike Kulturore (OP 4.11) duke shkaktuar ndikim në monumente, vende arkeologjike, ndërtesa të mbrojtura dhe burime tjera fizike kulturore;
- (f) nëse nënprojekti aktivizon politikën e BB për Projektet në Ujërat Ndërkombëtare (OP/PB 7.50) gjegjësisht, investimi mund të përfshijë përdorimin ose ndotjen ose në ndonjë mënyrë tjetër të ndikojë në cilësinë ose sasinë e një rruge ujore ndërkombëtare siç përcaktohet në OP/PB 7.50. Shumica e lumenjve dhe liqeneve të Kosovës, së paku ato më të mëdha dhe degët e tyre, mund të klasifikohen si ujëra ndërkombëtare;
- (g) nëse nënprojekti mbështet ndonjë blerje jo vullnetare të tokës ose zhvendosje jo vullnetare që do të aktivizonte politikën e BB-së për Zhvendosje Jo të Vullnetare OP/PB 4.12;
- (h) OP/BP 4.36 (Pyjet) nëse aktivitetet përfshijnë prerjet, zgjerimin e pyjeve, rryllëzimin, mbjelljen komerciale ose mund të ndikojnë në shëndetin e një pylli;
- (i) OP/BP 4.37 Siguria e Digave, nëse përfshin ndërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe aktivitete të tjera që lidhen me digat;
- (j) Projektet që bien në listën e përjashtimeve të IFR.

Pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kërkesat e Kosovës dhe janë marrë aprovimet, IFR-të duhet të ekzaminojnë projektin sipas kategorizimit të BB (Kategoria A, B, B+ ose C) bazuar në Pyetësin Mjedisor dhe dokumentet tjera, dhe sipas OP 4.01 si, dhe kushtet e kualifikueshmërisë të përcaktuara në këtë KMSM. Pas këtij shqyrtimi të përmbushjes së kriterëve, nëse nënprojekti kategorizohet si i kategorisë A ose me rrezik të lartë sipas kriterëve të BB dhe KMSM, atëherë duhet t'i deklarohet nën-përfituesit se kualifikohet për financim. Vetëm projektet që i përkasin kategorisë B ose kategorisë C mund të konsiderohen për financim në kuadër të këtij projekti.

9.1 Vlerësimi Social

Duke marrë parasysh natyrën e nënprojekteve potenciale, deri tani ato dominohen nga tregtia me shumicë dhe pakicë dhe sektori i shërbimeve, ndikimet e mundshme negative sociale pritet të jenë shumë të kufizuara. Çdo ndikim negativ potencial mbi shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, si dhe në pronën dhe pasurinë private do të përjashtohet me anë të procesit të shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve të shpjeguara në këtë kornizë. Çdo rrezik tjetër shoqëror do të adresohet në kuadër të dokumenteve të nevojshme për marrjen e lejes mjedisore sipas kërkesave ligjore të Kosovës, siç është prezantuar më sipër.

9.2 Mekanizmi i Zgjidhjes së Ankesave

Projekti do të krijojë një Mekanizëm për Zgjidhje të Ankesave (MZA) brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e Projektit për të adresuar çdo shqetësim që lidhet me projektin që dikush mund të sjellë, përfshirë NMVM-të përfituese dhe komunitetet e tyre pritëse. Projekti do të përdorë faqen ekzistuese të internetit të FKGK-

së për të ofruar informacione relevante për projektin, siç janë raportet e progresit, raportet e mbrojtjes, ngjarjet, aktivitetet etj. Faqja e internetit e FKGGK-së do të ketë informata kontakti për paraqitjen e ankesave nëpërmjet kanaleve të shumta (faqe interneti, e-mail, telefon, postë), si dhe një përshkrim mbi procedurat e MZA. Mundësia për të paraqitur ankesë nëpërmjet faqes së internetit do të komunikohet edhe përmes sesioneve informuese të Projektit, konsultimeve publike dhe punëtorive dhe materialeve të shtypura të prodhuara në kuadër të Projektit.

Një anëtar i stafit të FKGGK do të caktohet për të pranuar dhe për t'iu përgjigjur ankesave/reagimeve. Është parashikuar që ankesat do të marrin përgjigje, për sa kohë që janë plotësuar dy kriteret e mëposhtme: (i) kanë të bëjnë me ndonjë nga aktivitetet e Projektit; (ii) përmbajnë një sasi të mjaftueshme të detajeve për të treguar se një veprim malinj ka ndodhur ose ka gjasa të ndodhë, duke ndikuar në mirëqenien individuale ose kolektive ose duke paraqitur rrezik për mjedisin. Nëse ankesa mund të adresohet, anëtar i stafit i FKGGK-së i emëruar do të vazhdojë me veprimet që duhen ndërmarrë për të adresuar ankesën. Në rast se kriteri i dytë nuk është plotësuar plotësisht, anëtar i përkatës i stafit të FKGGK-së prapë se prapë do të bëjë hetime të mëtejshme (me ose pa kontaktuar ankuesin), si dhe do të ndërmarrë masa korrigjuese dhe do t'i përgjigjet ankuesit. Në rast se ankesa është anonime, reagimet do të jepen në faqen e internetit të Projektit.

10 DOKUMENTET E KUJDESIT TË DUHUR, KONSULTIMIT PUBLIK DHE PUBLIKIMIT

KMSM me listat kontrollues të mirë-elaboruara të PMMS-së për nënprojektet B- (ndërtim i vogël) do të publikohen për të paktën 14 ditë, në faqen e internetit të FKGGK-së në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Kopja e dokumentit duhet të jetë në dispozicion të publikut në recepsion. Në të njëjtën kohë, do të lëshohet një thirrje për konsultime përmes faqes së internetit të FKGGK-së dhe do të caktohet data dhe vendi për takimin konsultativ. FKGGK gjithashtu do të lansojë një thirrje për paraqitjen e komenteve dhe do të sigurojë adresën postare dhe elektronike për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve. Të gjitha komentet relevante dhe pyetjet e ngritura në/gjatë konsultimeve publike do të adresohen, pastaj do të përmbledhen dhe do t'i bashkëngjiten KMSM-së si Shtojca 4. Vetëm kur procesverbali i konsultimeve të përfshihet në KMSM dhe të shpaloset përsëri, do të konsiderohet përfundimtar. KMSM përfundimtare do të ripublikohet.

RFI-të do të publikojnë KMSM-në në faqen e tyre të internetit për t'vënë në dispozicion të aplikuesve dhe publikut KMSM-në dhe Listat kontrolluese të PMMS për nënkategoritë B- vetëm pas nënshkrimit të marrëveshjes për pjesëmarrje në projekt.

VM-të (PMMS) të përgatitura për nën-projektet individuale B + do të duhet të publikohen në gjuhën shqipe dhe serbe dhe nëse është e nevojshme, në gjuhën angleze dhe të ketë konsultime publike (të publikohen për të paktën 14 ditë) nga aplikuesi, Ministria përkatëse ose faqja e internetit e komunës me një thirrje për komente. Kopja fizike e dokumentit duhet të jetë në dispozicion edhe për publikun. Komentet do të kërkohen për dokumentet e publikuara (thirrja do të ofrojë edhe adresën postare dhe e-mailin për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve). Reklamat në gazetatat lokale mund të përdoren si mjet për të ftuar publikun të komentojë për të njëjtat dokumente. Të gjitha komentet relevante dhe pyetjet e ngritura në/gjatë konsultimeve publike do të adresohen, pastaj do të përmbledhen dhe do të bashkëngjiten në VM. Vetëm kur procesverbali i konsultimeve të përfshihet në dokument, do të konsiderohet përfundimtar.

Pasi që konsultohen në kuadër të konsultimeve publike të KMSM-së, Lista kontrolluese e PMMS për nënprojektet individuale B- nuk ka nevojë që sërish të merret pëlqimi i publikut/të ripublikohet (pasi që është publikuar si pjesë e KMSM), por rekomandohet që kjo të bëhet si një shenjë e praktikës së mirë.

11 PROCESI I SHQYRTIMIT MJEDISOR (RFI-TË, FKGK DHE BB)

Të gjithë aplikuesit (përdoruesit përfundimtarë të fondeve)/nën-projektet, FKGK dhe IFR-të do të ndjekin procesin e shqyrtimit mjedisor të paraqitur më poshtë:

HAPI 1: Aplikuesi përgatit një koncept fillestar të nënprojektit. Pas diskutimit jozyrtar me IFR, në të cilin IFR paralajmëron aplikantin për kërkesat e vlerësimit mjedisor, IFR shpërndan formularin e Pyetësorit për Mbrojtjen e Mjedisit (që duhet të dakordohet me IFR-në para nënshkrimit të marrëveshjes). Për më tepër, formulari i Pyetësorit për Mbrojtjen e Mjedisit do të ndërtohet mbi formularët ekzistues mjedisor të IFR duke shtuar informatat tjera të kërkuara nga politikat mbrojtëse të BB-së. Aplikuesi ofron informacionin e kërkuar dhe dorëzon pyetësin e plotësuar për Mbrojtjen e Mjedisit dhe dokumentacionin e kërkuar të IFR. Është përgjegjësi e aplikuesit të iniciojë diskutime me MMPH ose Komunën përkatëse në mënyrë që të përmbushë çdo kërkesë lokale apo kombëtare për shqyrtim mjedisor (të tilla si opinioni për procedurën e VNM dhe/ose lejet/aprovimet tjera zyrtare). Do të jetë përgjegjësi e Aplikuesit që të marrë lejet dhe licencat e duhura siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar me qëllim që të lehtësojë procesin e aprovimit nga MMPH ose Komuna përkatëse. Në kohën kur Aplikuesi kontakton IFR-në, të gjitha lejet dhe opinionet/pëlqimet/miratimet duhet të jenë marrë. Këto kërkesa konsiderohen të ndara, por paralele, me ato që paraqiten këtu dhe përmbushja e tyre është përgjegjësi e aplikuesit. Aplikuesi është përgjegjës për vlefshmërinë dhe vërtetësinë e informatave të dhëna në Pyetësin e Mbrojtjes së Mjedisit dhe dokumentet tjera.

HAPI 2: Në bazë të pyetësorit të dorëzuar të Mbrojtjes së Mjedisit, IFR kategorizon nën-projektin (si A ose i pa-kualifikuar ndryshe, B-, B+, C).

2.1: Për nën-projektet e kategorisë C, nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm përveç procedurave të brendshme të menaxhimit mjedisor të IFR-ve.

2.2: Për nën-projektet e kategorisë B+ IFR-të hartojnë Raportin e Shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve Mjedisore dhe e dorëzojnë atë (të shoqëruar me Pyetësin për Mjedisin dhe përshkrimin e projektit) te FKGK (Eksperti Mjedisor) për shqyrtim. FKGK konfirmon ose korrigjon rezultatin e shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve. IFR informon Aplikuesin për (i) kategorinë, (ii) procesin e VM dhe raportet e kërkuara

2.3: Për nën-projektet e kategorisë B, IFR shpërndan Listën kontrolluese të PMMS-së (Shtojca 2¹¹) te aplikuesi, i cili e bën atë pjesë të dokumenteve të ofertimit dhe kontraktimit. Kontraktuesi dhe Aplikuesi janë përgjegjës për zbatimin e saj.

HAPI 3: Nëse nënprojekti është i kategorisë B+, IFR i dërgon Aplikuesit formularin e PMMS-së në rast se PMMS nuk është pjesë e raportit të shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve (Shtojca 3). Aplikuesi përgatit PMMS-në dhe ia dërgon atë IFR-së (dhe FKGK-së dhe BB-së nëse kërkohet) për shqyrtim dhe aprovim ose komente. Në këtë fazë, Aplikuesi tashmë ka marrë lejen mjedisore komunale ose autorizimin mjedisor dhe lejet e tjera nëse kërkohet nga legjislacioni kombëtar. Kur IFR të jetë i kënaqur me dokumentet mjedisore, e miraton atë dhe e disburson huanë dhe kërkon garanci. PMMS-ja e aprovuar për kategorinë B+ është pjesë e (a) pakos së aplikimit për hua, (b) pakos së kërkesës për garanci, (c) dokumenteve të ofertimit dhe kontraktimit për Kontraktorët (nëse është e aplikueshme). Aplikuesi (dhe Kontraktorët) zbaton masat për zbutjen dhe monitorimin e PMMS. IFR kryen mbikëqyrjen dhe propozon veprime korrigjuese nëse është e nevojshme. Të paktën 3 PMMS-të e para të secilit IFR do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit nga FKGK. 5 PMMS-të e para do t'i miratimit nga BB.

¹¹ Listat kontrolluese të EMP janë të përgjithshme për ndërtimet e vogla, por lejojnë adresimin e veçorive shtesë të projektit

HAPI 4: IFR raporton pajtueshmërinë mjedisore të FKGK-ja në raportet e rregullta të progresit, minimumi një herë në gjashtë muaj. FKGK kryen mbikëqyrjen e nën-projekteve B+ të përzgjedhura.

HAPI 5: FKGK do të kryejë Auditimin Mjedisor për secilin nënprojekt të kategorisë B për të cilin aktivizohet garancia. Auditimi do të kryhet kundrejt rregullores kombëtare mjedisore, Politikave Mbrojtëse të BB-së dhe dokumenteve të kujdesit të duhur mjedisor për nën-projektin (KMSM dhe VM të përshtatshme për kategorinë e nënprojektit - PMMS për B+ dhe Lista kontrolluese e PMMS për nënprojektet e kategorisë B-). Për të gjitha nënprojektet e kategorisë B, përcaktimi i mospërputhshmërisë **domethënëse** gjatë auditimit mund të çojë në anulimin e garancisë, sipas ekspertit mjedisor të IFR. Rezultatet do të raportohen në Raportin e Auditimit Mjedisor.

IFR duhet të mbajë shënime të VM-ve (listat kontrolluese të PMMS për B- dhe PMMS për kategori B+) dhe dokumentet shoqëruese relevante (p.sh. manifestet dhe të dhënat e mbeturinave, ankesat, gjetjet e inspektimit dhe të ngjashme). Përveç mbikëqyrjes, Auditimet Mjedisore në rast se aktivizohet garancia do të vlerësohen kundrejt këtyre dokumenteve.

11.1 Monitorimi dhe raportimi

Procedurat e shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve, vlerësimit dhe aprovimit mjedisor të përshkruara më sipër janë pjesë e procedurave për përzgjedhjen dhe aprovimin e aplikacioneve për nënkredi. Pas nënshkrimit të një marrëveshje kredie dhe garancie dhe nënprojektet hyjnë në fazën e zbatimit, edhe punët mjedisore kalojnë në një fazë të re. Gjatë zbatimit të një nënprojekti, aplikuesit janë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme dhe aplikimin e masave zbutëse në përputhje me kërkesat e Raporteve të Vlerësimit Mjedisor (PMMS dhe Listat kontrolluese të PMMS). IFR-të pritet të monitorojnë pajtueshmërinë e nënhuamarrësit me VM-të (PMMS-të) dhe të raportojnë në FKGK mbi performancën mjedisore të klientëve të tyre si pjesë integrale e raportimit të tyre të rregullt mbi statusin e portofolit (të paktën në baza gjashtëmujore). Performanca mjedisore e IFR-ve do t'i nënshtrohet vlerësimit nga KGF dhe misionet mbikëqyrëse të BB. FKGK kryen mbikëqyrjen e nënprojekteve të përzgjedhura të kategorisë B.

BB do të bëjë shqyrtimin paraprak të pesë nën-projekteve të para B+ dhe do t'i miratojë ato para se të merret vendimi për garancinë e tyre. FKGK gjithashtu do të kontrollojë një mostër të pakove të nënkredive të kategorive B- dhe B+, si dhe nënprojektet e kategorisë C për të siguruar që IFR-të kanë kryer në mënyrë korrekte shqyrtimin e përmbushjes së kriterëve dhe kategorizimin e nënprojekteve; që vlerësimet mjedisore për nënprojektet e kategorisë B janë kryer në mënyrë adekuate dhe PMMS-të e prodhuara janë të kualitetit të pranueshëm. Vlerësimet e mbikëqyrjes do të sigurojnë që: puna ishte e një cilësie të kënaqshme, që kur ka qenë e përshtatshme ka pasur pjesëmarrje të komunitetit, që janë bërë rekomandimet e duhura, që të gjitha dokumentet janë vendosur në dosje dhe regjistruar si duhet dhe që janë përmbushur kushtet e aprovimit nga MMPH ose Komuna përkatëse.

KCGF do ta informojë BB-në për kujdesin e duhur mjedisor të aplikuar nga IFR përmes raportimit të përgjithshëm mbi progresin e projektit. BB do të përcjellë performancën mjedisore të FKGK dhe IFR-ve duke shqyrtuar rregullisht raportet e tyre, si dhe duke mbikëqyrur procesin e përgjithshëm të shqyrtimit dhe zbatimit të rekomandimeve mjedisore për nënprojektet e përzgjedhura, duke përfshirë vizitat e rastësishme në vendet e nënprojekteve dhe shqyrtimet e (raporteve) nga zyra. Praktika e tillë e mbikëqyrjes ka për qëllim të sigurojë që: puna ishte e një cilësie të kënaqshme, ka ndodhur pjesëmarrja e komunitetit kur ka qenë e përshtatshme, janë bërë rekomandimet e duhura, i gjithë dokumentacioni është vendosur në dosje dhe është regjistruar si duhet dhe se janë përmbushur kushtet e miratimit nga organet e autorizuara. Prandaj, IFR-të do t'i mbajnë në mënyrë të duhur të gjithë dokumentet e nënprojektit në dosje dhe do t'i vënë në dispozicion të FKGK dhe BB sipas nevojës, si dhe do të sigurojnë qasje në dosjet e nënprojekteve B+ dhe do të mundësojnë vizita në terren.

SHTOJCA 1 – PËRGJEGJËSITË KRYESORE TË PJESËMARRËSVE KRYESORË

Pjesëmarrësi	Aktiviteti	Dokumentet mbështetëse
KCGF	• Shpërndarja e manualit operacional te IFR-të • Asistimi i IFR-ve rreth kërkesave mjedisore • Raportimi i Performancës mjedisore të IFR • Auditimi Mjedisor në rast aktivizimi • Mbikëqyrja e kategorisë B+ • Së bashku me BB organizon trajnim të IFR-ve	• Raportet e progresit
RFI	• Finalizimi i formularit të shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve mjedisore • Shqyrtimi i pakos së aplikimit për nënhua për dokumentet e kërkuara mjedisore dhe licencat/lejet nga autoritetet shtetërore • Propozimi i kategorisë mjedisore • Shpërndarja e Listës kontrolluese të PMMS dhe PMMS-së • Mbajtja e dosjeve të plota të dokumenteve mjedisore për shqyrtim nga FKGK dhe BB • Kontrollimi i pajtueshmërisë me planet e zbutjes (kategoria B+) • Përmirësimi i vazhdueshëm SMMS	• Përfshirja e informatave mjedisore me aplikacionin për nënhua • Përfshirja e informatave të monitorimit mjedisor në raportimin e rregullt të portofolit në FKGK • Përfshirja e dokumenteve mjedisore në të dhënat normale të IFR.
Përfituesit Nënhuamarrësit	• Plotësimi i pyetësorit mjedisor • Dorëzimi i konceptit të nënprojektit te IFR • Aranzhimi dhe financimi i PMMS, nëse aplikohet • Marrja e aprovimit nga MMPH/Autoriteti Komunal nëse kërkohet • Marrja e lejeve/licencave të kërkuara • Implementimi i PMMS • Raportimi	• Kopjet e lejeve • Deklarata e aprovimeve • Vendimi nga MMPH se a nevojitet VNM • Raporti i Shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve Mjedisore (nëse është relevant) • PMMS (nëse është relevante Shih shtojcën 3)
BB (IBRD)	• Organizim i trajnimit për stafin e IFR dhe FKGK lidhur me procedurat e shqyrtimit mjedisor dhe avancimit të SMMS • Kryerja e shqyrtimit të mëpasshëm (për projektet e para të kategorisë B+) • Identifikimi i problemeve/çështjeve dhe propozimi i zgjidhjes • Projektet që kërkojnë politikat mbrojtëse të BB të ndryshme nga kërkesat e OP 4.01 do të shqyrtohen nga eksperti mjedisor i Bankës Botërore.	• Dokumentimi i gjendjes të zbatimit të projektit në Raportet për gjendjen e zbatimit dhe rezultateve dhe shënimet ndihmëse të misionit

SHTOJCA 2 – LISTA KONTROLLUESE E PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR

Hyrje

Qëllimi i projektit të KSFF është përmirësimi i qasjes në financa për NMVM-të. Komponenti 1 i projektit Avancimi i Kornizës të Garancisë Kreditore ka për qëllim rritjen e bazës së kapitalit të FKGK, zgjerimin e gamës së produkteve të ofruara.

Rezultatet e pritura do të jenë përmirësimi i qasjes në financa për NMVM-të dhe avancimi i infrastrukturës së pagesave. Në nivelin e PDO, këto rezultate do të maten nga shuma e financimit të lëvruara përmes FKGK dhe raporti i pagesave pa para në dorë për kokë banori. Projekti përfshin dy komponentët vijuese përveç përkrahjes për koordinimin dhe zbatimin e projektit:

- Avancimi i kornizës të garancisë kreditore: rezultatet e pritura për këtë komponent janë rritja e qëndrueshme e vëllimit të garancive të pjesshme kreditore, përmirësimi i kapacitetit institucional dhe zgjerimi i gamës së produkteve.
- Krijimi i “switch” kartelës për pagesa: Rezultatet e pritura për këtë komponent janë funksionalizimi i “switch” qendrës me ndërveprim të përmirësuar dhe kosto më të ulëta të transaksioneve.

Kategoria mjedisore

Në përputhje me OP-të e BB-së, dizajni i projektit kërkon kategorinë IF. FKGK, Agjencia implementuese për Komponentin 1, është themeluar me qëllimin e vetëm për të dhënë garanci për bizneset e targetuara - NVM-të dhe nuk vepron në asnjë fushë tjetër. Si e tillë, dhe me kredi të kufizuar në 1.000.000 euro, aktivitetet e projektit nuk pritët të prodhojnë ndikime të konsiderueshme dhe afatgjata mjedisore. Projekti do të ofrojë injektim të përgjithshëm kapital për FKGK në kuadër të nënkomponentit 1.1, megjithatë, lëshimi i garancisë do të lëshohet në bazë të huasë për hua. Sektorët e targetuar të nënkomponentit 1.2 përfshijnë disa që potencialisht shkaktojnë ndotje, të tillë si, por pa u kufizuar në: bujqësia, efikasiteti energjetik dhe menaxhimi i mbeturinave. Garancitë mund të lëshohen për huatë infrastrukturore dhe për prodhim, por jo në mënyrë retroaktive. Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMSM) u zhvillua si udhërrëfyes për krijimin e procedurave të shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve, VM-së dhe shqyrtimit mjedisor për të gjitha nënprojektet e mbështetura nga kreditë e garantuara gjatë implementimit të projektit, si dhe ato të mbështetura nga pilot skemat e reja.

KMSM përjashton të gjitha aktivitetet me rrezik të lartë dhe të kategorisë A. Gjithashtu, përcakton kërkesat për ndërtimin e kapaciteteve dhe mekanizmat e zgjidhjes së ankesave si pjesë e procedurave të kujdesit të duhur mjedisor dhe social.

Projekti do të mbështesë nënprojektet e kategorisë B. Këto janë projektet të diellit me ndikime të mundshme negative mjedisore tek njerëzit dhe mjedisi, janë më pak të dëmshme sesa ato të projekteve të Kategorisë A. Këto ndikime janë për vende specifike; edhe nëse ka pak prej tyre janë të pakthyeshme; dhe në shumicën e rasteve mund të projektohen masa zbutëse më lehtë se sa për projektet e Kategorisë A. Shtrirja e VM për një projekt të kategorisë B mund të ndryshojë nga nënprojekti në nënprojekt.

Për qëllimet e këtij projekti, duke marrë parasysh specifikat e sa, kategoria B është ndarë në dy nënkategori:

- a) Kategorija B- për të cilën zbatohet kjo listë kontrolli e PMMS. Kategorija B- përfshin nënprojekte që përfshijnë përmirësime të thjeshta, punime të vogla civile, ndërtime të vogla (p.sh. anekset e vogla në ndërtesa ekzistuese dhe objekte të vogla mbështetëse, ndërtime të thjeshta, por jo projekte të reja të mëdha ndërtimi), si dhe rindërtime, rehabilitime ose përshtatje të ndërtesave ekzistuese. Për projekte të tilla është përgatitur kjo listë kontrolluese e PMMS dhe është konsultuar publikisht si pjesë e kësaj KMSM. Lista kontrolluese e PMMS-së do të shpërndahet nga IFR-të për aplikuesit/kontraktuesit e nënprojekteve të kategorizuara si B1 dhe do të aplikohen gjatë implementimit. Aplikuesi është përgjegjës për implementimin e listës kontrolluese të PMMS dhe respektimin e rregullores kombëtare. Lista kontrolluese e PMMS do të jetë pjesë e ofertave dhe dokumenteve kontraktuese me kontraktuesit e punëve nëse është e aplikueshme. Aplikuesi dhe/ose kontraktori i aplikuesit janë përgjegjës për zbatimin e listës kontrolluese të PMMS. Këto do të kontrollohen në baza të rastësishme nga IFR-të, FKGK-ja dhe ndoshta BB. Në kushte të jashtëzakonshme projektet e tjera mund të bien në kategorinë B+.
- b) Kategorija B+ për të cilën **nuk zbatohet** kjo listë kontrolluese e EMP. Kategorija B+ përfshin nënprojektet që janë të listuara në Shtojcën II të Ligjit të VNM të Kosovës për të cilat nuk kërkohet VNM e plotë sipas opinionit të MMPH. Për këto nënprojekte, një Raport i Shqyrtimit të përmbushjes së kritereve i cili përfshin PMMS do të përgatitet në bazë të opinionit me shkrim të MMPH-së se VNM-ja nuk është e nevojshme. Për këtë lloj të punëve PMMS do të publikohet dhe konsultohet me publikun në faqen e internetit të Ministrisë ose komunës ose në faqen e internetit dhe në tabelën informuese të aplikuesit. Nëse kërkohet, do të publikohet edhe Leja Komunale Mjedisore. Në raste të jashtëzakonshme projektet e tjera mund të bien në kategorinë A.

Ndikimet e mundshme mjedisore

Ndikimet mjedisore të projektit pritet të jenë me ndikim të menaxhueshëm, të përkohshëm dhe lokal, pasi ato lidhen me aktivitete të përgjithshme të ndërtimit në lokacione të njohura dhe të përdorura më parë. Këto ndikime më së shpeshti përfshijnë: a) pluhur dhe zhurmë për shkak të gërmimit, rrënimit dhe ndërtimit; b) menaxhim të mbeturinave të rrënimit të ndërtimeve dhe derdhjen aksidentale të vajit të makinës, lubrifikantëve, etj.; c) shkelje të një prone private; d) dëmtim të pronës historike ose kulturore ose vendndodhjeve arkeologjike të panjohura; e) shqetësim të trafikut; f) ujë sipërfaqësor ose nëntokësor; dhe g) ndotje të tokës ose erozion.

LISTA KONTROLLUESE E PMMS

PJESA 1: INSTITUCIONALE & ADMINISTRATIVE		
Shteti	Kosova	
Titulli i projektit	FUQIZIMI I SEKTORIT FINANCIAR NË KOSOVË	
Aktiviteti i projektit		
Aranzhimet institucionale (Emri dhe kontaktet)	Menaxhimi i projektit	
	Kush është përgjegjës për projektin (personi kontaktues)	Cila bankë e garanton
LEGJISLACIONI DHE LEJET		
Identifikimi i legjislacionit të zbatueshëm kombëtar dhe lokal dhe i lejeve që zbatohen për aktivitet	○ Pëlqimi/Leja mjedisore - kërkohet (); lëshohet (); n/a () ○ Leja mjedisore komunale - kërkohet (); lëshohet (); n/a () ○ Autorizimi mjedisor- kërkohet (); lëshohet (); n/a () ○ Leja për shfrytëzim të ujit- kërkohet (); lëshohet (); n/a () ○ Leja për shkarkimin e ujërave të zeza- kërkohet (); lëshohet (); n/a () ○ Leja ndërtimore - kërkohet (); lëshohet (); n/a () ○ Licencat ose Leja për shfrytëzim të burimeve natyrore/minerale- kërkohet (); lëshohet (); n/a () ○ Tjetër: _____	
KONSULTIMI PUBLIK		
Identifikimi se ku/kur ka ndodh procesi i konsultimit publik	Informatat për vendin dhe datën e publikimit do të vendosen në: ○ Faqja e internetit e kompanisë ○ Tabelën informuese të kompanisë ○ Tjetër: _____ Data: _____	

PJESA 2: SHQYRTIMI I PËRMBUSHJES SË KRITEREVEI MJEDISOR/SOCIAL

A do të përfshijë ndonjë nga këto në fillim aktiviteti në lokacion:	Aktiviteti	Statusi	Referenca shitesë
	A. Rehabilitim i ndërtesës	[] Po [] Jo	Shih pjesën B më poshtë
	B. Ndërtim i ri	[] Po [] Jo	Shih pjesën B më poshtë
	C. Sistem individual i trajtimit të ujërave të zeza	[] Po [] Jo	Shih pjesën C më poshtë
	D. Ndërtesa dhe çarqe historike	[] Po [] Jo [] e mundur	Shih pjesën D më poshtë
	E. Marrje të tokës ¹²	[] Po [] Jo	Shih pjesën E më poshtë
	F. Materiale të rrezikshme ose helmuese ¹³	[] Po [] Jo	Shih pjesën F më poshtë
	G. Ndikime në pyje dhe/ose zona të mbrojtura	[] Po [] Jo	Shih pjesën G më poshtë
	H. Trajtimi/menaxhimi i mbetjeve mjekësore	[] Po [] Jo	Shih pjesën H më poshtë
	I. Siguria në trafik dhe e këmbësorëve	[] Po [] Jo	Shih pjesën I më poshtë
	J. Të tjera që aplikohen	[] Po [] Jo	Shih pjesën J më poshtë

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA KONTROLLUESE E MASAVE ZBUTËSE
A. Kushtet e përgjithshme	Njoftimi dhe siguria e punëtorëve	(a) (b) Të gjitha lejet që kërkohen ligjërisht janë marrë për ndërtimin dhe/ose rehabilitimin (c) Publiku është njoftuar për punimet përmes njoftimeve të duhura në medie dhe/ose në vende të qashtme nga publiku (përfshirë vendin e punimeve)

¹² Marrja e tokës përfshin marrjen e pavullnetshme të tokës (shpronësim) që rezulton në zhvendosjen e njerëzve, humbjen e pasurisë ose qasjes në asete dhe humbjen e burimeve të të ardhurave ose mjeteve të jetesës siç përcaktohet në OP/BP 4.12 të Bankës Botërore. Kjo përfshin tokën e blerë/dorëzuar dhe ndikimin në personat që nuk kanë të drejtë ligjore të njohur ose pretendim ndaj tokës, por jetojnë dhe/ose në mënyrë të paligjshme ekzistojnë dhe/ose kryejnë veprimtari afariste (kabinat) në tokën tashmë të blerë.

¹³ Materiali helmues/i rrezikshëm përfshin dhe nuk kufizohet në asbest, ngjyra toksike, heqje të ngjyrosjes së plumbit, etj.

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA KONTROLLUESE E MASAVE ZBUTËSE
		(d) (e) Të gjitha punët do të kryhen në një mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar, të dizajnuara për të minimizuar ndikimet ndaj banorëve fqinjë dhe mjedisit. (f) PPE e punëtorëve do të jetë në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare (gjithmonë helmetat, si dhe maskat e nevojshme dhe syzet e sigurisë, pajimet, dhe çizmet e sigurisë) (g) Shënjimi i duhur i vendeve do t'i informojë punonjësit për rregullat dhe rregulloret kryesore që duhet të ndjekin.
B. Aktivitete të përgjithshme rehabilitimi dhe/ose ndërtimi	Cilësia e ajrit	(a) Përdorimi i kanaleve të jashtme për hedhjen e mbetjeve gjatë rrëtimeve të brendshme mbi katet e para. (b) Gjatë rrëimit mbetjet të mbahen në zona të kontrolluara dhe të spërkaten me ujë për të reduktuar pluhurin nga mbetjet (c) Zhdukja e pluhurit gjatë shpimit pneumatik/shkatërrimit të murit përmes spërkatjes së vazhdueshme me ujë dhe/ose instalimit të bllokuesve të pluhurit në vendpunishte (d) Ruajtja e mjedisit rrethues (trotuareve, rrugëve) nga mbetjet për të minimizuar pluhurin (e) Nuk do të ketë dëgjie të hapur të mbetjeve ndërtimore/materialeve në vendpunishte (f) Nuk do të ketë vërshime të tepruara të makinave të ndërtimit në vendpunishte
	Zhurma	(a) Zhurma e ndërtimit do të kufizohet në kohë të kufizuara sipas ligjit për zhurmën (b) Gjatë operimit, mbulesat e motorëve të gjeneratorëve, kompresorëve të ajrit dhe pajisjeve të tjera mekanike duhet të jenë të mbyllura dhe pajisjet të vendosura sa më larg nga zonat e banuara të jetë e mundur
	Cilësia e ujit	(a) Vendpunishtja do të krijojë masat e përshtatshme të kontrollit të erozionit dhe sedimenteve, të tilla si p.sh. dengje sane dhe/ose gardhe nga balta për të parandaluar që sedimentet të lëvizin jashtë vendpunishtes dhe të shkaktojnë turbullim të tepruar në rrjedhat dhe lumenjtë aty pranë.
	Menaxhimi i mbeturinave	(a) Do të identifikohen rrugët dhe vendet e grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave për të gjitha llojet kryesore të mbetjeve që priten nga aktivitetet e prishjes dhe të ndërtimit. (b) Mbeturinat minerale të ndërtimit dhe rrëimit do të ndahen nga mbeturinat e përgjithshme, mbeturinat organike, të lëngshme dhe kimikatet përmes klasifikimit në vendpunishte dhe do të ruhen në kontejnerë të përshtatshëm. (c) Mbeturinat ndërtimore do të grumbullohen dhe deponohen siç duhet nga grumbulluesit e licencuar (d) Të dhënat e deponimit të mbeturinave do të mbahen si dëshmi për menaxhimin e duhur sipas dizajnit. (e) Kurdo që është e mundur, kontraktuesi do të ripërdorë dhe riciklojë materialet e përshtatshme dhe të qëndrueshme (përveç azbestit)
C. Sistem individual i	Cilësia e ujit	(a) Qasja ndaj trajtimit të mbetjeve sanitare dhe ujërave të zeza nga vendet e ndërtimit (instalimi ose rindërtimi) duhet të aprovet nga autoritetet lokale

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA KONTROLLUESE E MASAVE ZBUTËSE
trajtimin të ujërave të zeza		(b) Para se të shkarkohen në ujërat pritëse, ujërat e shkarkuara nga sistemet individuale të ujërave të zeza duhet të trajtohen në mënyrë që të plotësojnë kriteret minimale të cilësisë të përcaktuara në udhëzimet kombëtare për cilësinë e shkarkimeve dhe trajtimin e ujërave të zeza (c) Do të kryhet monitorimi (përpara/pas) i sistemeve të reja të ujërave të zeza
D. Ndërtesat historike	Trashëgimia kulturore	(a) Nëse ndërtesa është një strukturë historike e përcaktuar, shumë afër një strukture të tillë, ose ndodhet në një zonë historike të caktuar, njoftohen dhe merren aprovimet/lejet nga autoritetet kompetente (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit) dhe adresohen të gjitha aktivitetet ndërtimore në përputhje me legjislacionin lokal dhe kombëtar (b) Sigurohet që ka dispozita që nëse zbulohen artefakte ose gjetje të tjera të mundshme të gjetura gjatë gërmimeve ose ndërtimit do të shënohen, të kontaktohen zyrtarët dhe të shtyhen punimet ose të modifikohen për të marrë në konsideratë gjetjet e tilla.
E. Marrja e tokës	Plani/Korniza e marrjes së tokës	(a) Nëse shpronësimi i tokës nuk është pritur dhe tani kërkohet ose nëse nuk pritej humbja e qasjes në të ardhura të shfrytëzuesve ligjor ose joligjor të tokës por mund të ndodhë, nënprojekti i propozuar nuk do të kualifikohet për financim.
F. Materialet helmuese	Menaxhimi i asbestit	(a) Nëse gjendet azbest në vendin e projektit të shënohet qartë si material i rrezikshëm (b) Kur është e mundur azbesti futen në kontejnerë si duhet dhe plombohet për të minimizuar ekspozimin (c) Para largimit (nëse largimi është i domosdoshëm) azbesti do të trajtohet me agjent lagës për të minimizuar pluhurin e azbestit (d) Azbesti do të trajtohet dhe asgjësohet nga profesionistët me përvojë (e) Nëse materiali i azbestit do të ruhet përkohësisht, mbetet duhet të mbyllet në mënyrë të sigurtë në kontejnerë të mbyllur dhe të shënohen si duhet (f) Azbesti i larguar nuk do të përdoret përsëri
	Menaxhimi i mbeturinave helmuese/të rrezikshme	• Ruajtja e përkohshme në vendpunishte e të gjitha lëndëve të rrezikshme ose helmuese do të bëhet në kontejnerë të sigurt të etiketuar me detaje të përbërjes, përmbajtësve dhe informata për trajtimin • Kontejnerët e substancave të rrezikshme duhet të vendosen në një enë të mbrojtur nga rrjedhjet për të parandaluar rrjedhjen dhe kullimin • Mbeturinat transportohen nga transportuesit e licencuar posaçërisht dhe vendosen në një objekt të licencuar. • Nuk do të përdoren ngjyra me përbërës helmues ose tretës ose me ngjyra të bazuara në plumb
G. Ka ndikim në pyje dhe/ose zona të mbrojtura	Mbrojtje	(a) Të gjitha habitatet e njohura natyrore dhe zonat e mbrojtura në afërsi të aktivitetit nuk do të dëmtohen ose shfrytëzohen, të gjithë personelit do t'i ndalohet rreptësisht nga gjuetia, ushqimi, prerjet ose aktivitete të tjera dëmtoese. (b) Drurët e mëdhenj në afërsi të aktivitetit, të shënohen dhe rrethohen me gardh të madh dhe të mbrohet sistemi rrënjor dhe të shmanget çfarëdo dëmtimi i drunjve

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA KONTROLLUESE E MASAVE ZBUTËSE
		(c) Ligatinat dhe rrjedhat e afërta do të mbrohen nga rrjedhjet prej vend ndërtimit, me tipare të përshtatshme të kontrollit të erozionit dhe sedimentit duke përfshirë por duke mos u kufizuar në dengjet sane, gardhe të baltës (d) Nuk do të ketë gropa, gurorë apo deponi të mbetjeve të palicencuara në zonat ngjitur, veçanërisht jo në zonat e mbrojtura.
H. Asgjësimi i mbetjeve mjekësore (nuk aplikohet)	Infrastruktura për menaxhimin e mbetjeve mjekësore	(a) Në përputhje me rregulloret kombëtare, kontraktuesi do të sigurojë që objektet e kujdesit shëndetësor të ndërtuara rishtazi dhe/ose rehabilituara përfshijnë infrastrukturë të mjaftueshme për trajtimin dhe deponimin e mbetjeve mjekësore; kjo përfshin dhe nuk kufizohet vetëm në: ▪ Pajisjet speciale për mbeturinat e ndara të kujdesit shëndetësor (duke përfshirë instrumentet e ndotura "të mprehta", dhe indet ose lëngjet e njeriut) nga mbeturinat e tjera për hedhje; dhe ▪ Ekzistojnë hapësira të përshtatshme magazinimi për mbetjet mjekësore; dhe ▪ Nëse aktiviteti përfshin trajtim të bazuar në objekt, ekzistojnë opsione të duhura të hedhjes dhe janë funksionale
I Trafiku dhe siguria e këmbësorëve	Rreziqet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për trafikun publik dhe këmbësorët nga aktivitetet ndërtimore	(a) Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, kontraktuesi do të sigurojë që vendi i ndërtimit të jetë i sigurt siç duhet dhe trafiku i lidhur me ndërtimin të jetë i rregulluar. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në ▪ Vendosja e shenjave, shenjat paralajmëruese, pengesat dhe devijimet e trafikut: vendi do të jetë i dukshëm dhe publiku i paralajmëruar për të gjitha rreziqet e mundshme ▪ Sistemi i menaxhimit të trafikut dhe trajnimi i stafit, sidomos për qasjen në vendpunishte dhe trafikun e rënduar pranë vendpunishtes. Sigurimi i kalimeve dhe kapërcimeve të sigurta për këmbësorët, aty ku ndërhyrja e trafikut i ndërtimit. ▪ Rregullimi i orarit të punës për modelet e trafikut lokal, p.sh. duke shmangur aktivitetet e mëdha të transportit gjatë orëve të pikut ose kohës së lëvizjes së kafshëve ▪ Menaxhimi aktiv i trafikut nga stafi i trajnuar dhe i dukshëm në vend, nëse kërkohet për kalim të sigurt dhe të përshtatshëm për publikun. ▪ Sigurimi i qasjes së sigurt dhe të vazhdueshme në objektet e zyrave, dyqanet dhe rezidencat gjatë aktiviteteve të rinovimit, nëse ndërtesat qëndrojnë të hapura për publikun.
J Tjera	Ndikimet shtesë _____	Masat zbutëse shtesë_____

PJESA 3: PLANI I MONITORIMIT

RFI dhe FKGK do të monitorojnë implementimin e masave zbutëse gjatë vizitës së tyre në vendpunishte.

SHTOJCA 3 – SHABLLONI I PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) i një projekti përbëhet nga një sërë masash zbutëse, monitoruese dhe institucionale që duhet të ndërmerren gjatë implementimit dhe operimit për të eliminuar ndikimet e dëmshme mjedisore dhe sociale, kompensimin e tyre ose zvogëlimin e tyre në nivele të pranueshme. Plani përfshin gjithashtu veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre masave.

1. Planet e menaxhimit janë elemente thelbësore të raporteve të VM për projektet e Kategorisë A; për shumë projekte të Kategorisë B VM-të mund të rezultojnë vetëm në planin e menaxhimit. Për të përgatitur planin e menaxhimit, pranuesi dhe ekipi i tij i projektimit të VM (a) identifikojnë grupin e përgjigjeve ndaj ndikimeve potencialisht të dëmshme; (b) përcaktojnë kërkesat për të siguruar që këto reagime bëhen në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur; dhe (c) përshkruajnë mjetet për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Në mënyrë më specifike, PMMS përfshin komponentët e mëposhtëm:

Zbutja

2. PMMS identifikon masat e mundshme dhe me kosto efektive që mund të zvogëlojnë ndikimet potencialisht të konsiderueshme të dëmshme mjedisore në nivele të pranueshme. Plani përfshin masat kompensuese nëse masat zbutëse nuk janë të realizueshme, me kosto efektive ose të mjaftueshme. Në mënyrë të veçantë PMMS;

(a) Identifikon dhe përmbledh të gjitha ndikimet e rëndësishme të dëmshme mjedisore të parashikuara (duke përfshirë ato që përfshijnë njerëzit vendës ose rivendosjen e pavullnetshme);

(b) Përshkruan me detaje teknike çdo masë zbutëse, duke përfshirë llojin e ndikimit me të cilin lidhet dhe kushtet në të cilat kërkohet (p.sh. vazhdimisht ose në raste të jashtëzakonshme), së bashku me dizajnet, përshkrimet e pajisjeve dhe procedurat operative, sipas rastit;

(c) parasheh cilindo ndikim të mundshëm mjedisor të këtyre masave; dhe

(d) Siguron lidhje me planet e tjera zbutëse (p.sh., popujt autoktonë ose pronën kulturore) që kërkohen për projektin.

Monitorimi

3. Monitorimi i mjedisit gjatë zbatimit të projektit siguron informata për aspektet kryesore mjedisore të projektit, veçanërisht ndikimet mjedisore të projektit dhe efektivitetin e masave zbutëse. Një informacion i tillë i mundëson marrësit dhe Bankës që të vlerësojë suksesin e zbutjes si pjesë e mbikëqyrjes së projektit dhe lejon ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese kur është e nevojshme. Prandaj, PMMS identifikon objektivat e monitorimit dhe specifikon llojin e monitorimit, me lidhjet me ndikimet e vlerësuara në raportin e VM dhe masat zbutëse të përshkruara në PMMS. Në mënyrë të veçantë, seksioni i monitorimit i PMMS siguron (a) një përshkrim specifik dhe detaje teknike të masave monitoruese, duke përfshirë parametrat që duhen matur, metodat që do të përdoren, vendet e marrjes së mostrave, frekuencën e matjeve, kufijtë e zbulimit (aty ku është e përshtatshme)

dhe përkufizimin e pragjeve që do të sinjalizojnë nevojën për veprime korrigjuese; dhe (b) monitorimin dhe procedurat e raportimit për (i) sigurimin e zbulimit të hershëm të kushteve që kërkojnë masa të posaçme zbutëse, dhe (ii) japin informata mbi progresin dhe rezultatet e zbutjes.

Orari i implementimit dhe vlerësimi i kostos

4. Për të tre aspektet (zbutja, monitorimi dhe zhvillimi i kapaciteteve), PMMS siguron (a) një orar implementimi për masat që duhet të kryhen si pjesë e projektit, duke treguar fazën dhe koordinimin me planet e përgjithshme të implementimit të projektit; dhe (b) vlerësimet e kostos kapitale dhe korrente dhe burimet e fondeve për implementimin e PMMS. Këto shifra gjithashtu integrohen në tabelat e përgjithshme të kostos së projektit.

Plani i zbutjes

Faza e ndërtimit					
Aktiviteti	Ndikimi i prituri mjedisor	Masa e propozuar për zbutje	Përgjegjësia për implementimin e masës zbutëse	Periudha e implementimit të masës zbutëse	Kostoja e lidhur me implementimin e masës zbutëse
1.					
2.					
...					
Faza operative					
1.					
2.					
...					

Plani i monitorimit

Faza e ndërtimit					
Çfarë	Ku	Si	Kur	Nga kush	Sa
<i>Parametri do të monitorohet ?</i>	<i>Është parametri që do të monitorohet?</i>	<i>Do të monitorohet parametri (çka duhet të matet dhe si)?</i>	<i>Do të monitorohet parametri (koha dhe shpeshtësia)?</i>	<i>Do të monitorohet parametri—(përgjegjësia)?</i>	<i>Është kosto e lidhur me implementimin e monitorimit</i>
1.					
2.					
...					
Faza operative					

SHTOJCA 4 – PROCESVERBALI I TAKIMEVE KONSULTATIVE PËR KMSM

Konsultimet për KMMS u mbajtën në ambientet e FKKG-së në Prishtinë më 22 shkurt 2019. Paraprakisht, dokumenti ishte publikuar në faqen e internetit të FKKG-së (më 12 shkurt 2019) dhe ishte në dispozicion në kopje të shtypur në ambientet e Fondit për 14 ditë. Informacioni për shpalljen, të ndjekura nga konsultimet publike, ishin postuar në faqen e internetit të FKKG-së. Të dyja, dokumenti dhe njoftimi, ishin ofruar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Përveç kësaj, ftesat iu ishin dërguar hisedarëve me e-mail.

Figura 1. Njoftimi publik në gjuhën shqipe

FOND KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Kontakt / Q / Shqip ▼

Për ne | Produktet dhe shërbimet tona | Partnerët tanë | **Lajme/Publikime** | Mundësitë

Lajme
Publikime
Statistika
Foto Galeria
Video

12 shkurt 2019

THIRRJE PËR KONSULTIME PUBLIKE

FOND KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

THIRRJE PËR KONSULTIME PUBLIKE

Për kornizën e menaxhimit mjedisor dhe social për projektin e propozuar për
FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR NË KOSOVË nga BANKA BOTËRORE

Synimi i projektit është përmirësimi i qasjes në financa për NMVA-të, të cilat njekohësisht, së bashku me huadhenjësit, janë edhe përfitueset kryesore. Sipas politikës së Bankës Botërore për vlerësimin e mjedisit, gjatë procesit të VM-së, agjencia zbatuese konsultohet me grupet e prekura nga projekti.

Ky dokument aplikohet vetëm në të gjitha aktivitetet në kuadër të Projektit për fuqizimin e sektorit financiar në Kosovë dhe mund ta gjeni këtu: www.fondikgk.org/sq/politikat

Korniza për Menaxhimin Mjedisor dhe Social është dokument draft dhe së presim të përditësojmë Shtojcën 8 brenda ditëve të ardhshme. Publiku do të informohet për aneksin e përditësuar në vegërin: www.fondikgk.org/sq/lajme-publikime

Shpallja publike dhe thirrja për komente dhe propozime lidhur me Kornizën e propozuar të menaxhimit mjedisor dhe social do të mbahet në periudhën nga data 12 shkurt 2019 deri më 26 shkurt 2019.

Rojmë publikun të parashtrijë mendimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me Kornizën e propozuar të menaxhimit mjedisor dhe social me së largu deri më 21 shkurt 2019 në agjencinë zbatuese duke përdorur adresat kontaktuese si vijon:

e-mail: nora.anti@fondikgk.org

postë: Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (për: Thirrjen për konsultime publike)

Rr. Anton Çetta SA 10 000 Prishtinë

Prezantimi publik i Kornizës do të mbahet më 22 shkurt 2019 nga ora 10.00 në hapësirat e FKKG-së në rrugën Anton Çetta SA, Prishtinë, Kosovë.

Njoftim 21 shkurt 19: Shtojca 8 e dokumentit Korniza për Menaxhimin Mjedisor dhe Social është përditësuar dhe tani është pjesë e draftit final të dokumentit.

f t

PER NE
Misioni
Vlerat Institucionale
Synimet tona
Historia
Struktura Organizative
Bordi i Drejtorëve
Personeli
Na kontaktoni

FOND KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
Rrëzueshmëria
Përkrahimi i Shërbimeve
Bazimet që kualifikohen
Sektorët dhe qelimet e kreditorit që ndalohen
Procesi i miratimit të shërbimeve
Politikat
Llogaritë për themelimin e FKKG-së

PARTNERËT TANË
Donatorët
Bashkëpunëtorët
Institucionet Financiare të Regjistruara

LAJME/PUBLIKIME
Lajme
Publikime
Statistika
Foto Galeria
Video

MUNDËSITË
Mundësi publike
Mundësi Partnerit

LIQNET E NEVOJSHME
➔ USAID
➔ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
➔ Shërbimet e Bankave të Kosovës

FOND KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

E-mail **ABONOHU**

Figura 2. Njoftimi publik në gjuhën serbe



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Kontakt / Q / Srpski ▼

O Nama | Naši Proizvodi i Usluge | Naši partneri | **Novosti i dešavanja** | Prilike

Vesti
Publikacije
Statistika
Galerija
Video Snimci

12 Februar 2019

POZIV NA JAVNE KONSULTACIJE



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

POZIV NA JAVNE KONSULTACIJE
o okviru upravljanja sredinom i socijalnog upravljanja u predloženom
PROJEKTU ZA JAČANJE FINANSIJSKOG SEKTORA NA KOSOVU od SVETSKE BANKE
Cilj Projekta je poboljšanje pristupa finansijama za MMSP-e, koji su istovremeno, uz zajmodavce, glavni korisnici. Prema politici Svetske banke o oceni sredine, tokom procesa OS, agencija sprovodilac se konsultuje sa grupama na koje se odnosi projekat.
Ovaj dokument se odnosi jedino na sve aktivnosti u okviru Projekta za jačanje finansijskog sektora na Kosovu i možete ga naći ovde: www.fondikgk.org/sr/pravilnici
Dokument Okvir za upravljanje životnom sredinom i socijalnim pitanjima je nacrt dokumenta i mi očekujemo ažuriranje Aneksa 8 u narednih nekoliko dana. Javnost će biti obavještena o ažuriranom aneksu na: www.fondikgk.org/sr/novosti
Javno objavljivanje i poziv za komentare i predloge o predloženom Okviru za upravljanje sredinom i socijalno upravljanje će biti održani u periodu između 12. februara 2019. i 26. februara 2019.
Pozivamo javnost da dostavi svoja mišljenja i sugestije o predloženom Okviru za upravljanje sredinom i socijalno upravljanje najkasnije do 21. februara, agenciji sprovodiocu koristeći sledeće kontakt adrese:
e-mail: nora.arifi@fondikgk.org
pošta: Kosovski Fond za Garantno Jemstvo (za Poziv na javne konsultacije)
Ul. „Anton Çetta“ SA 10 000 Priština
Javna prezentacija Okvira će biti držana 22. februara 2019. u 10.00 časova u prostorijama KFKJ u ul. „Anton Çetta“ SA, Priština, Kosovo.
Obaveštenje 21 februar19: Aneks 8 Dokumenta Okvira za upravljanje životnom sredinom i socijalnim pitanjima je ažuriran i sada je deo konačnog nacrt dokumenta.




O NAMA
Misija
Institucionalne vrednosti
Naši ciljevi
Istoria
Organizaciona struktura
Odbor Direktora
Kadar
Kontaktirajte Nas

NAŠI PROIZVODI I USLUGE
Dodavanje
Opis Usluga
Kvalifikovana MMSP
Zabranjeni sektori i svrhe za kredit
Proces odobravanja jemstva
Pravilnici
Zakon o osnivanju FKGGK

NAŠI PARTNERI
Donatori
Sarandici
Registrovane Finansijske institucije

NOVOSTI I DEŠAVANJA
Vesti
Publikacije
Statistika
Galerija
Video Snimci

PRILIKE
Prilike za zapošljavanje
javni pozivi

KORISNI LINKOVI
> USAID
> Centralna Banka Republike Kosova
> Kosovo Banking Association



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

E-mail

PRETPLATITI SE

38

Figura 3. Njoftimi publik në gjuhën angleze



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Contact / Q / English ▼

About Us | Our products and services | Our Partners | **News/Publications** | Announcements

News

Publications

Statistics

Gallery

Videos

12 February 2019

CALL FOR PUBLIC CONSULTATIONS



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

CALL FOR PUBLIC CONSULTATIONS

on the Environmental and Social Management Framework for the proposed

KOSOVO FINANCIAL SECTOR STRENGTHENING PROJECT FINANCED by the WORLD BANK

The objective of the Project is to improve access to finance for MSMEs, which in the same time are the main beneficiaries together with the lenders. According to the World Bank policy on Environmental Assessment, during the EA process, the Implementing Agency consults project-affected groups.

This document applies to all activities under the Kosovo Financial Sector Strengthening Project solely and you can find it here: www.fondikgk.org/en/policies.

The Environmental and Social Management Framework document is a draft document, and that we expect to update Annex 8 within the next few days. The public will be informed about the updated annex in the link: www.fondikgk.org/en/news-publications.

Public disclosure and call for comments and proposals on proposed Environmental and Social Management Framework will be held in the period between 12 February to 26 February 2019.

We invite the public for the submission of their opinions and suggestions on the proposed Environmental and Social Management Framework no later than 21 February 2019 to the Implementing Agency using the contact details below:

e-mail: nora.arifi@fondikgk.org

mail: Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (for Call for Public Consultation)

Anton Çetta SA 10 000 Prishtina

The public presentation of the Framework will be held on 22 February, 2019 at 10 a.m. in the KCGF premises, at Anton Çetta SA, Prishtina, Kosovo.

Notice 21 February 19: Annex 8 of the Environmental and Social Management Framework document has been updated and now is part of the final draft of the document.




ABOUT US
Mission
Institutional Values
Our objectives
History
Organizational Structure
Board of Directors
Staff
Contact us

OUR PRODUCTS AND SERVICES
Additionality
Description of Services
Eligible MSMEs
Prohibited credit sectors and purposes
Guarantee Approval Process
Policies
Law on the Establishment of PKGK

OUR PARTNERS
Donors
Collaborators
Registered Financial Institutions

NEWS/PUBLICATIONS
News
Publications
Statistics
Gallery
Videos

ANNOUNCEMENTS
Job Opportunities
RFPs/RFOs/RFAs

USEFUL LINKS
> USAID
> Central Bank of Kosovo
> Kosovo Banking Association



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

E-mail

SUBSCRIBE





39

Takimi filloi në orën 10:30. Të pranishëm ishin: përfaqësues të FK GK, znj. Nora Arifi - Menaxhere e Lartë e Garancive, z. Partin Pruthi - Zyrtar i Lartë Ligjor, z. Kastriot Këpuska - Agro Ekspert, përfaqësuesi i BKT: z. Mentor Berisha - Drejtor i Departamentit për Korporata dhe Biznes, përfaqësuesi i BPB: z. Bujar Statovci - Udhëheqës i Departamentit të Biznesit Mikro dhe Agro, përfaqësuesi i NLB: z. Viktor Halili - Zyrtar i Lartë për Përputhshmëri, përfaqësuesi i PCB: z. Gëzim Tropoja - Udhëheqës i Njesisë së Mjedisit, dhe përfaqësuesi i RBKO: z. Blerim Terziqi - U. D. i Portfolios dhe Kontrollit të Riskut.

Asnjë hisedar tjetër nuk ka shprehur interes për të marrë pjesë në këtë konsultim publik dhe nuk është pranuar asnjë informatë kthyesë gjatë periudhës së konsultimeve.

Fotografia 1 Konsultimi publik në ndërtesën e FK GK-së



Takimi publik dhe diskutimi u kryesua nga znj. Arifi. Znj. Arifi filloi me një prezantim të shkurtër të Projektit për fuqizimin e sektorit financiar të Kosovës, objektivin e Projektit dhe rëndësinë në drejtim të përmirësimit të qasjes në financa për NMMV-të.

Më tej, u prezantua Dokumenti Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS), duke filluar me një hyrje të shkurtër të rëndësisë së KMMS-së për Projektin. U prezantuan pjesë të ndryshme të KMMS-së duke u fokusuar në procesin e shqyrtimit mjedisor dhe në listën e kontrollit të masave lehtësuese për investimet në nivel nën-projekti. U konstatua se ka shumë kërkesa sfiduese për Institucionet Financiare për të modifikuar politikat dhe procedurat e brendshme, si dhe përfshirjen e FKGK-së në vlerësimin e kategorisë B+.

Fotografia 2 Kopjet fizike të KMMS-së në zyrat e FKGK-së



Ekzistojnë dy konkluzione të dallueshme nga konsultimi publik:

- (a) sfida e kërkesës së përgatitjes së KMMS-së nga klienti (kategoria B+) dhe miratimi nga RFI-a dhe FKGK-ja.

Përgjigja në konkluzionin: Çështja është shqyrtuar dhe diskutuar me Bankën Botërore. Kërkesa e paraqitur në KMMS është miratuar sipas kërkesave minimale të Politikës OP/BP 4.01 (vlerësimi mjedisor). Megjithatë kjo kërkesë është sipas kërkesave të MMPH-së, si pjesë e procedurave për Lejen ose Autorizimin Mjedisor, pritet që me rritjen e kapaciteteve të hisedarëve, projekti do të mund të mbështetet më shumë në procedurat e vendit.

- (b) FKGK duhet të hartojë një doracak operativ për të lehtësuar vlerësimin mjedisor për bankat.

Përgjigja në konkluzionin: FKGK do të përcaktojë doracakun operativ në bashkëpunim me bankat në mënyrë që të përshtaten procedurat sa më shumë që të jetë e mundur.

Në fund të takimit u konkludua se FKGK ka bërë përpjekje të mëdha për të informuar hisedarët e ndryshëm dhe qytetarë të cilët do të jenë në gjendje të dërgojnë komentet e tyre deri më 26 shkurt 2019.

Figura 4. Lista e pjesëmarrësve



Public Consultation for Environmental and Social Management Framework
22-Feb-19

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni	Numri i telefonit	E-mail	Nenshkrimi
1	BUJAR STATOVCI	BBB		bujar.statovci@bpbkade.com	
2	MENTOR BERISHA	BKT		M.Berisha@BKT.com.mk	
3	VIKTOR HALILI	NLB		VIKTOR.HALILI@NLB-KOS.COM	
4	Gëzim Tropoja	ProCredit		gtropoja@procreditkosat-kos.com	
5	BERIM TERZI	EBKO		berim.terzi@nftk.com.mk	
6	PERTINI PRUTHI	FKGK		PERTINI.PRUTHI@FONDIFKGK.COM	
7	Nora Anli	FKGK		noragajdondikgu.org	
8	KASTRIOT KEPUSEA	FKGK		KASTRIOT.KEPUSEA@FONDIFKGK.COM	
9					
10					
11					
12					
13					
14					

SHTOJCA 5 – PROJEKTET E LISTUARA NË SHTOJCËN I TË LIGJIT PËR VNM PËR TË CILAT KËRKOHEJ VNM

1. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve

1. Instalimet e pjekjes ose sinterizimit të mineraleve metalike (duke përfshirë edhe mineralet e sulfurit).
2. Fabrikat për hedhjen e hekurit dhe çelikut (fuzioni primar ose sekondar), duke përfshirë hedhjen e vazhdueshme.
3. Fabrikat/shkretoret për përpunimin e metaleve me ngjyra:
 - 3.1. Punuesit e çekanëve me output të energjisë që tejkalon pesëdhjetë (50) KJ për çekiç, ndërsa inputi i energjisë tejkalon njëzet (20) KW;;
 - 3.2. aplikimi i veshjeve metalike të përziera mbrojtëse të mbrojtura me input që tejkalon një (1) ton/orë çeliku bruto;
 - 3.3. shkretore për prodhimin e metaleve me ngjyra me kapacitet më të madh se njëqind (100) ton/ditë.
4. Fabrikat/shkretoret për:
 - 4.1. prodhimin e metaleve me ngjyra dhe prodhimin e metaleve pa ngjyra të papërpunuara nga xehet; koncentratet ose lëndët e para sekondare me procese metalurgjike, kimike ose elektrolitike;
 - 4.2. Shkrirjen, përfshirë prodhimin e aliazheve, duke përfshirë produktet e rigjeneruara (rafinimi, hedhja në shkretore, etj.) me prodhim që kalon një (1) ton/ditë për plumbin dhe kadmiumin ose dhjetë (10) ton/ditë për metalet e tjera.
5. Fabrikat për trajtimin sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur procese elektrolitike ose kimike ku vëllimi i buteve të trajtimit tejkalon dhjetë (10) m³.
6. Instalimet për trajtimin sipërfaqësor të substancave ose produkteve që përdorin tretës organikë, veçanërisht për shtresimin, pikturimin, zhdukjen, mbrojtjen nga uji dhe infiltrimi me ngjyra, pastrimi ose shtypja kur shuma e tretësve të përdorur tejkalon njëqind (100) ton/vit.
7. Prodhimi dhe përpunimi i aliazheve nga metalet e hekurit që përmbajnë arsenik, merkur dhe plumb, me kapacitet më të madh se një mijë (1.000) ton/vit.

2. Industria minerale

8. Fabrikat e çimentos që përmbajnë furrë rrotulluese (pjekje dhe tharje) me kapacitet prodhimi më të lartë se treqind (300) ton/ditë ose fabrika që prodhojnë gëlqere me rrëshqitje me kapacitet prodhimi prej tridhjetë (30) ton/ditë ose më shumë, llojet e furrave me kapacitet prodhimi prej tridhjetë (30) ton/ditë ose më shumë.
9. Fabrikat për prodhimin e materialeve duke përdorur procese të tilla si kalcifikimi dhe pjekja e mineraleve që përmbajnë elementë toksikë si, merkur, arseniku dhe kadmiumi.
10. Fabrika për prodhimin e qelqit, duke përfshirë prodhimin e fibrave të qelqit, me kapacitet prodhues prej dhjetë (10) ton/ditë ose më shumë.
11. Shkretore për shkrirjen e substancave minerale, duke përfshirë prodhimin e fibrave minerale, me një kapacitet prodhues prej dhjetë (10) ton/ditë ose më shumë.
12. Fabrikat për prodhimin e produkteve të qeramikës, përmes ndezjes, sidomos prodhimin e tullave, pllakave, tullave refraktare, gurit dhe porcelanit, me kapacitet prodhues prej tridhjetë (30) ton/ditë ose më shumë.
13. Instalime për nxjerrjen e azbestit dhe për përpunimin dhe transformimin e asbestit dhe produkteve të tjera që përmbajnë asbest, si: produkte asbest-çimento, me prodhim vjetor prej më shumë se pesë mijë (5.000) ton të produkteve të gatshme; për material fërkimi, me prodhim

vjetor prej më shumë se pesëdhjetë (50) ton të produkteve të gatshme; dhe për përdorime të tjera të asbestit, shfrytëzimi i më shumë se dyqind (200) ton/vit.

14. Fabrikat për pjekjen dhe sinterizimin e mineraleve jo metalike me kapacitet prodhues prej tridhjetë (30) ton/ditë ose më shumë.

3. Industria nxjerrëse

15. Gurëthyesit dhe nxjerrja e argjilës me mihje sipërfaqësore, ku sipërfaqja e lokacionit kalon pesë (5) ha, ose nxjerrja e torfës, ku sipërfaqja e lokacionit tejkalon dhjetë (10) ha ose përfshin nxjerrjen e pesëmbëdhjetë mijë tonëve (15.000) ose më shumë/vit.

16. Nxjerrja dhe përpunimi (përveç lëngëzimit dhe gazifikimit) të qymyrit, linjitit dhe mineraleve bituminoze me kapacitet prodhimi prej pesëdhjetë mijë (50.000) ton/vit ose më shumë

4. Industria kimike

17. Aktivitete të integruara për prodhim industrial, nëpërmjet proceseve kimike, të substancave të vetme ose grupeve të substancave, të renditura në nënparagrafët 17.1 deri 17.7:

17.1. Prodhimi i kimikateve bazë organike, si:

17.1.1. hidrokarbure të thjeshta (lineare ose ciklike, të ngopura ose jo të ngopura, alifatike ose aromatike);

17.1.2. hidrokarburet që përmbajnë oksigjen të tilla si: alkoolët, acidet karboksilike, eterët, acetone, peroksidet, rrëshira epoksi;

17.1.3. hidrokarburet e sulfatit;

17.1.4. hidrokarburet e azotit, siç janë aminat, amidet, komponimet e azotit, komponimet e nitratave, nitritet, cianidet, izocianidet;

17.1.5. hidrokarburet me përmbajtje fosfori;

17.1.6. hidrokarburet halogjenë;

17.1.7. komponente organometalike;

17.1.8. materialet bazë plastike (polimere me fibra sintetike dhe fibra me bazë celuloze);

17.1.9. gomë sintetike;

17.1.10. ngjyra dhe pigmente;

17.1.11. agjentë sipërfaqësorë aktivë.

17.2. Prodhimi i kimikateve bazë joorganike, të tilla si:

17.2.1. gazra, si amoniaku, klori, ose klorid hidrogjeni, fluori ose hidrogjeni, dioksidi i karbonit, komponimet e squfurit, hidrogjeni, dioksidi i squfurit, fluoridi karbonil;

17.2.2. acide, të tilla si: acid kromik, acid fluoridik, acid fosforik, acid nitrik, acid klorhidrik, acid sulfurik, acid sulfurik;

17.2.3. bazat, të tilla si hidroksid amoniak, hidroksid kaliumi, hidroksid natriumi;

17.2.4. kripërat, të tilla si karbonati i kaliumit, karbonati i natriumit, zbardhuesit e bazuar në borat natriumi ose kaliumi, nitrat argjendi;

17.2.5. jo metalet, oksidet metalike dhe kombinime të tjera joorganike, të tilla si: karabit kalciumi, silici, karabit silikon;

17.3. Prodhimi i plehrave kimike me bazë fosfati, azoti, ose kaliumi (plehra të thjeshta ose komplekse);

17.4. Prodhimi i produkteve bazë të shëndetit të bimëve dhe biocideve;

17.5. Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike, ngjyrave dhe pesticideve, duke përdorur një proces kimik ose biologjik;

17.6. Prodhimi i substancave shpërthyes;

17.7. Prodhimi i aditivëve të proteinave, fermenteve dhe substancave të tjera proteinike duke përdorur procese kimike dhe biologjike.

5. Industria e Energjisë

18. Stacionet e termoelektrike dhe instalimet e tjera me djegie, me prodhim të nxehtësisë prej pesëdhjetë (50) MW ose më shumë.
19. Centralet e Energjisë Bërthamore.
20. Instalimi i linjave elektrike të tensionit të lartë me një minimum prej dyqind njëzet (220) kV dhe me gjatësi më të gjatë se dhjetë (10) km.
21. Rafineritë e naftës së papërpunuar dhe instalimet për gazifikimin dhe lëngëzimin e qymyrit dhe shistës bituminoze dhe instalimet për bonifikimin e vajrave të përdorura që përfshijnë shuma prej njëqind mijë (100.000) ton/vit ose më shumë.
22. Instalimet për ruajtjen e naftës, produkteve petrokimike ose kimike me një kapacitet prej njëqind mijë (100.000) ton ose më shumë.
23. Instalimet për ruajtjen e materialeve radioaktive.

6. Infrastruktura e transportit

24. Ndërtimi i linjave për trafikun hekurudhor të distancave të gjata dhe të aeroporteve me një gjatësi bazë të pistës prej dy mijë e njëqind (2100) m ose më shumë.
25. Ndërtimi i një rruge të re me dy ose më shumë korsi, ose rikonstruksioni dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese për të siguruar dy ose më shumë korsi, ku rruga e tillë e re, ose rikonstruksioni dhe / ose pjesa e zgjeruar do të jetë pesë (5) km ose më shumë në gjatësi të vazhdueshme.
26. Tubacionet me diametër prej pesëqind (500) mm ose më shumë dhe gjatësi prej dhjetë (10) km ose më shumë për transportin e:
 - 26.1. gazit natyror, naftës ose kimikateve, dhe
 - 26.2. rrymat e dioksidit të karbonit (CO₂) për qëllime të magazinimit gjeologjik, duke përfshirë stacionet ndihmëse të lidhura.
27. Tubacionet me diametër tetëqind (800) mm ose më shumë dhe një gjatësi prej dyzet (40) km për transportin e rrymave të dioksidit të karbonit (CO₂) për qëllime të magazinimit gjeologjik, duke përfshirë stacionet ndihmëse të lidhura.

7. Industria ushqimore

28. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve ushqimore nga:
 - 28.1. materialet e papërpunuara me origjinë shtazore (me përjashtim të qumështit) ku kapaciteti prodhues i produktit përfundimtar tejkalon tridhjetë (30) ton/ditë;
 - 28.2. materialet e papërpunuara me origjinë bimore ku kapaciteti prodhues i produktit përfundimtar kalon dyqind e pesëdhjetë (250) ton/ditë (mesatarja e bazuar në vlerën tremujore);
 - 28.3. produktet e qumështit, ku sasia e qumështit të trajtuar tejkalon njëqind (100) ton/ditë (mesatarja e bazuar në shumën vjetore);

8. Trajtimi dhe Asgjësimi i Mbeturinave dhe Ujërave të Zeza

29. Instalime për djegie, rikuperim, trajtim kimik ose mbushje toke të mbeturinave të rrezikshme.
30. Objektet për djegien e mbeturinave komunale, me input prej 1 ton/orë ose më shumë.
31. Deponitë për mbetjet jo të rrezikshme, me input prej tridhjetë (30) ton/ditë ose më shumë.
32. Impiantet për trajtimin e ujërave të zeza komunale me një kapacitet që tejkalon ekuivalentin e popullsisë prej njëqind mijë (100.000).
33. Impiantet për trajtimin e ujërave të zeza industriale.

9. Projektet e magazinimit, transferimit dhe furnizimit me ujë

34. Nxjerrja e ujërave nëntokësore ose skemat e rimbushjes artificiale të ujërave nëntokësore ku vëllimi vjetor i ujit të nxjerrë ose rimbushur është i barabartë ose i tejkalon pesë (5) milion metra kub.

35. 1. Punimet për transferimin e burimeve ujore ndërmjet pellgjeve lumore, ku transferimi ka për qëllim parandalimin e mungesës së mundshme të ujit dhe ku sasia e ujit të transferuar tejkalon tridhjetë (30) milion m³/vit.

35. 2. Në të gjitha rastet e tjera, punimet për transferimin e burimeve ujore ndërmjet pellgjeve lumore, ku rrjedha mesatare shumëvjeçare e pellgut nga ku bëhet abstragimi tejkalon gjashtëqind (600) milion m³/vit dhe ku shuma e transferuar tejkalon 5% të kësaj rrjedhe. Në të dyja rastet përjashtohen transferet e ujit të pijshëm të tubuar.

36. Digat dhe instalimet tjera të projektuara për mbajtjen mbrapa ose ruajtjen e përhershme të ujit, ku një sasi e re ose shtesë e ujit të mbajtur ose e magazinuar tejkalon pesë (5) milion m³.

10. Industritë e Letrës, Drurit, Tekstilit dhe Lëkurës

37. Instalimet për prodhimin e letrës dhe kartonit që tejkalojnë njëqind mijë (100.000) m²/vit.

38. Impiantet industriale për:

38.1. Prodhimin e pulpës nga lëndë drusore ose materiale të ngjashme fibroze;

38.2. Prodhimin e letrës dhe kartonave me një kapacitet prodhues më të madh se pesëdhjetë (50) ton/ditë.

39. Prodhimi i mobileve me input druri ose materiali tjetër bazë më të madh se dhjetë mijë (10.000) m³/vit.

40. Impiantet për para-trajtim (operacione të tilla si larja, zbardhja, mercerizimi) ose ngjyrosje të tekstileve fibresore.

41. Fabrikat për rrezitje të lëkurës.

11. Bujqësia intensive

42. Instalimet për rritjen intensive të shpendëve, derrave apo bagëtisë me më shumë se:

42.1. dhjetë mijë (10.000) shpezë;

42.2. pesëqind (500) derra;

42.3. njëqind (100) krerë kafshë; dhe

42.4. një mijë (1000) bagëti të vogla;

12. Projekte të tjera

43. Instalimet për dhënien ose asgjësimin e kafshëve të ngordhura.

44. Hapësirat për ruajtjen gjeologjike të dioksidit të karbonit.

45. Instalimet për kapjen e rrymave të CO₂ për qëllime të ruajtjes gjeologjike nga instalimet e mbuluara nga kjo Shtojcë ose ku kapja totale vjetore e CO₂ është 1,5 megaton ose më shumë.

46. Çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të listuara në këtë Shtojcë, kur një ndryshim apo zgjerim i tillë në vetvete plotëson pragjet, nëse ka, të përcaktuara në këtë Shtojcë.

SHTOJCA 6- PROJEKTET E LISTUARA NË SHTOJCËN II TË LIGJIT KOMBËTAR PËR VNM

1. Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi:

- 1.1. Projektet për shfrytëzimin e tokës së pakultivuar ose të zonave gjysmë-natyrore për qëllime bujqësore intensive;
- 1.2. Projektet e menaxhimit të ujit për bujqësinë, duke përfshirë ujitjen dhe projekte të kullimit të tokës;
- 1.3. Pyllëzimi fillestar dhe shpyllëzimi, për qëllime të konvertimit në një lloj tjetër të shfrytëzimit të tokës;
- 1.4. Kultivimi intensiv i peshkut.

2. Industria nxjerrëse

- 2.1. Guroret, gurëthyesit, nxjerrja e mineraleve në të hapur dhe nxjerrja e torfës duke përfshirë vendet që identifikohen për miniera zejtare të menaxhuara nga komuna (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 2.2. Miniera nëntokësore;
- 2.3. Nxjerrja, shkatërrimi dhe mineralet e tjera përmes pastrimit të shtretërve të lumenjve;
- 2.4. Shpime të thella, në veçanti:
 - 2.4.1. Shpime gjeotermale; dhe
 - 2.4.2. Shpimi për furnizim me ujë, me përjashtim të shpimeve për hetimin e stabilitetit të tokës;
- 2.5. Instalimet sipërfaqësore për nxjerrjen e qymyrit, linjitet dhe mineraleve bituminoze (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

3. Industria e Energjisë

- 3.1. Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit dhe ujit të nxehtë (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 3.2. Instalimet industriale për transportin e gazit, avullit dhe ujit të nxehtë; transmetimin e energjisë elektrike nga kabllot e larta (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 3.3. Magazinimi sipërfaqësor i gazit natyror;
- 3.4. Magazinimi nëntokësor i gazeve të djegshme;
- 3.5. Magazinimi sipërfaqësor dhe nëntokësor i materialeve të lëngshme djegëse (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1) dhe magazinimi në sipërfaqen e tokës të karburanteve fosile;
- 3.6. Briketimi industrial i qymyrit dhe linjitet;
- 3.7. Instalimet për përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive (përveç nëse përfshihen në Shtojcën I);
- 3.8. Instalimet për prodhimin e energjisë hidroelektrike (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 3.9. Instalime për shfrytëzimin e energjisë së erës për prodhimin e energjisë; Burimet e vazhdueshme të rrezatimit (jonizues dhe jo-jonizues).
- 3.10. Instalimet për kapjen e rrymave të CO₂ për qëllime të ruajtjes gjeologjike (instalimet që nuk mbulohen nga Shtojca I);

4. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve

- 4.1. Instalime për prodhimin e hekurit ose çelikut me hedhje të vazhdueshme;
- 4.2. Instalime për përpunimin e metaleve me ngjyra (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 4.3. Shkritore të metaleve të ngjyrosura (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 4.4. Instalimet për shkrirjen, duke përfshirë aliazhin, e metaleve pa ngjyra, përfshirë produktet e rigjeneruara (rafinimi, hedhja në shkritore etj.), (Projektet që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

- 4.5. Instalime për trajtimin sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 4.6. Prodhimi dhe montimi i automjeteve motorike dhe prodhimi i motorëve të automjeteve motorike;
- 4.7. Instalime për pjekjen dhe sinterizimin e xeheve metalike;
- 4.8. Instalime për ndërtimin dhe riparimin e avionëve;
- 4.9. Prodhimi i pajisjeve hekurudhore;
- 4.10. Shkatërrimi me eksploziv

5. Industria minerale

- 5.1. Furrat e koksit (distilimi i qymyrit të thatë);
- 5.2. Instalime për prodhimin e çimentos (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.3. Instalime për prodhimin e asbestit dhe prodhimin e produkteve të asbestit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.4. Instalimet për prodhimin e qelqit duke përfshirë fibrat qelqi (projektet që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.5. Instalimi për shkrirjen e substancave minerale duke përfshirë prodhimin e fibrave minerale (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.6. Prodhimi i produkteve qeramike me ndezje, në veçanti pllaka mbulimi, tulla, tulla refraktare, pllaka, gresi ose porcelani (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.7. Fabrikat për prodhimin e asfaltit;
- 5.8. Fabrikat për prodhimin e betonit.

6. Industria kimike

- 6.1. Trajtimi i produkteve të ndërmjetme dhe prodhimi i kimikateve;
- 6.2. Prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, ngjyrave dhe bojërave, elastomereve dhe peroksive (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 6.3. Objektet e magazinimit për naftën, produktet petrokimike dhe kimike.

7. Industria ushqimore

- 7.1. Prodhimi i vajrave dhe yndyrave vegjetale dhe shtazore (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.2. Paketimi dhe konservimi i produkteve të kafshëve dhe perimeve;
- 7.3. Prodhimi i produkteve të qumështit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.4. Mbushja e birrës (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.5. Prodhimi i ëmbëlsirave dhe i shurupit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.6. Instalimet për therjen e kafshëve;
- 7.7. Instalimet industriale për prodhimin e farines;
- 7.8. Fabrikat e sheqerit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1).

8. Industria e tekstilit, lëkurës, drurit dhe letrës

- 8.1. Fabrikat për prodhimin e letrës dhe kartonit (projektet që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 8.2. Impiantet për para-trajtim (larje, zbardhues, mercerizim) ose ngjyrosja e fibrave ose tekstileve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 8.3. Impiantet për rrezitje të lëkurës.
- 8.4. Instalimet për përpunimin dhe prodhimin e celulozës.

9. Industria e gomës

9.1. Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me bazë elastomeri.

10. Projektet e infrastrukturës

10.1. projekte të zhvillimit të pasurive industriale;

10.2. projektet e zhvillimit urban, duke përfshirë ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkingjet e makinave;

10.3. ndërtimi i hekurudhave dhe objekteve të transportit intermodal dhe të terminaleve intermodale (projekte që nuk përfshihen në Aneksin 1);

10.4. ndërtimet për aeroportet dhe fushat ajrore (projektet që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

10.5. ndërtimi i rrugëve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

10.6. ndërtimi ose modifikimi i rrugëve ujore në brendësi;

10.7. projektet për parandalimin e përmbytjeve duke përfshirë modifikimet në kanalet e lumenjve (projektet që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

10.8. digat apo instalimet të tjera të projektuara për mbajtjen e ujit ose për ruajtjen e tyre në baza afatgjata (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

10.9. Ndërtimi ose modifikimi i tramvajeve, hekurudhave të ngritura ose nëntokësore, linjave të ngritura ose linjave të ngjashme të një lloji të veçantë, që përdoren ekskluzivisht ose kryesisht për transportin e udhëtarëve;

10.10. Instalimet e tubacioneve të naftës dhe gazit dhe tubacionet për transportin e rrymave të CO₂ për qëllime të ruajtjes gjeologjike (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I).

10.11. Abstraksionet e ujërave nëntokësore dhe skemat artificiale të rimbushjes së ujërave nëntokësore (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

10.12. Punimet për transferimin e burimeve ujore ndërmjet pellgjeve të lumenjve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1).

11. Turizmi dhe koha e lirë

11.1. Pista skijimi, ski-lifte dhe teleferikë dhe aktivitetet e lidhura;

11.2. Fshatrat dhe komplekset e hoteleve jashtë zonave urbane dhe zhvillimet shoqëruese;

11.3. Vendet e përhershme të kampimit dhe karvaneve;

11.4. Parqet tematike;

11.5. Instalimet e infrastrukturës në zonat e mbrojtura, që nuk përfshihen në planet hapësinore.

12. Projekte të tjera

12.1. Shtigje të përhershme të garave dhe testimeve për automjete të motorizuara;

12.2. Instalimet për asgjësimin e mbeturinave (projektet që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

12.3. Impiante të trajtimit të ujërave të zeza (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

12.4. Vendet e depozitimit të llumrave (projektet që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

12.5. Magazinimi i hekurit dhe materialeve tjera për skrap, përfshirë automjetet për skrap;

12.6. Instalimet për prodhimin e fibrave minerale artificiale (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

12.7. Instalime për rikuperimin ose shkatërrimin e substancave shpërthyes;

12.8. Vende për asgjësimin e mbeturinave industriale jo të rrezikshme;

12.9. Vende për ruajtjen dhe përpunimin e kafshëve të ngordhura dhe të padëshiruara (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

12.10. Industritë ushqimore (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1 ose në seksionin 7 më sipër).

- 12.11. Çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të dhëna në Shtojcën I ose Shtojcën II tashmë të autorizuar, ekzekutuara ose në proces të ekzekutimit, të cilat mund të kenë efekte të konsiderueshme negative në mjedis (ndryshim ose zgjerim që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- 12.12. Projektet në Shtojcën I, të ndërmarra ekskluzivisht ose kryesisht për zhvillimin dhe testimin e metodave ose produkteve të reja dhe që nuk përdoren për më shumë se dy (2) vjet.

SHTOJCA 7 – LISTA E AKTIVITETEVE QË I NËNSHTROHEN LEJES MJEDISORE KOMUNALE

LISTA E AKTIVITETEVE QË I NËNSHTROHEN LEJES MJEDISORE KOMUNALE

1. Auto-serviset,
2. Autolarjet,
3. Auto serviset me automjete jashtë përdorimit deri në 20 pjesë,
4. Pikat e gazit (LNG) deri në 5m³;
5. Pikat e karburantit me kapacitet deri në 50m³;
6. Sharrë për materiale druri
7. Fabrika për përpunimin e drurit, mobilieri, etj., deri në 1000m³/vit.
8. Furre për prodhimin e bukës dhe produkteve të tjera të miellit;
9. Rrjete kanalizimi të ujërave të zeza dhe rehabilitimi i tyre me gjatësi deri në 5 km
10. Ndërtimi dhe rehabilitimi i ujësjellësit, në gjatësi deri në 5 km
11. Rindërtimi i rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (gjatësia deri në 5 km);
12. Thertoret;
13. Prodhimi i gëlqeres
14. Prodhimi i elementeve të betonit dhe parafabrikuara, pllakave, etj., kapaciteti i projektuar deri 2m³ beton/orë
15. Ruajtja e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimin për komunat që kanë më pak se 60.000 banorë
16. Rritja e peshkut në pellgje artificiale, sipërfaqe deri në 300m²
17. Pishinat, pa objektet hoteliere dhe ndërtesat ndihmëse
18. Punëtori për përpunimin e mermerit
19. Ndërtimi i ndërtesave të banimit kolektiv (hotelieri, tregti, komercializëm, biznes, etj.) me sipërfaqe të bazuar në 450m² ose sipërfaqe të përgjithshme të ndërtesës mbi 1500m²
20. Aktivitete kompostimi, me shumën totale, deri në 100m³ ose 40 ton/vit
21. Magazina për plehra dhe pesticide
22. Objektet e shërbimit të ushqimit (qebaptore, ëmbëltore, kuzhinë popullore, restorante, etj.)
23. Vende ose qendra për grumbullimin dhe akumulimin e mbeturinave, në të cilat ruhen mbeturina të ngurta (plastike, letre dhe xhami), në sasi deri në 30t
24. Instalime për rritjen intensive të shpendëve, derrave, bagëtive dhe kopeve të mëdha që kanë më pak se: 5000 shpendë; 250 derra; 50 kafshë; 500 bagëti të vogla.
25. Instalime për shfrytëzimin e energjisë së erës për prodhimin e energjisë deri në 100kW/h.
26. Sistemet e energjisë diellore dhe sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/avullit, deri në 100kW/h/
27. Stacionet për telefon celular.
28. Vendet për bagëtinë, të hapura dhe të mbyllura.
29. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit.

- 30. Qendrat e artizanatit
- 31. Shërbimet (servisimi i pajisjeve teknike dhe elektronike)
- 32. Studiot fotografike
- 33. Prodhimi i dyerve dhe dritareve plastike.

SHTOJCA 8 – SISTEMET EKZISTUESE TË SHQYRTIMIT TË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE MJEDISORE DHE TË MENAXHIMIT TË BANKAVE KOMERCIALE (RFIS)

RFI-të kanë implementuar kapacitete dhe praktika të ndryshme në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS). Tre banka ndërkombëtare: TEB, Raiffeisen dhe ProCredit Bank janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit, pasi ato kanë SMMS të mirë elaboruara dhe këtu është një përshkrim i përgjithshëm. Bankat e sipërpërmendura kanë krijuar sisteme të avancuara të menaxhimit mjedisor që janë të mjaftueshme për menaxhimin e nën-projekteve të kategorisë C dhe B.

Procedurat e menaxhimit mjedisor dhe social të Raiffeisen Bank Kosovë

Politikat e Menaxhimit të Rrezikut Mjedisor dhe Social të krijuara paraqesin një grup të detajuar udhëzuesish që marrin parasysh aspektet mjedisore të projekteve të kredituara dhe shkojnë përtej kërkesave kombëtare në menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale. Politika është përpunuar mirë dhe përfshin procedurat, standardet, udhëzimet dhe format e menaxhimit të gjithanshëm dhe të harmonizuar të mjedisit. Ndër të tjera, Banka angazhohet të përfshijë konsideratat mjedisore dhe sociale në aktivitetet e saj të financimit, duke përcaktuar objektiva mjedisore dhe sociale që adresojnë qëndrueshmërinë, duke siguruar kujdes të thellë mjedisor për projektet me rrezik të lartë dhe duke ndihmuar klientët në identifikimin, adresimin dhe zbutjen e rreziqeve mjedisore dhe sociale. Në dokument, Banka paraqet një listë përjashtimi që i ngjan asaj të Grupit të BB.

Procesi i kujdesit të duhur mjedisor dhe social i bazuar në politika përbëhet nga katër hapat e mëposhtëm: shqyrtimi i përmbushjes së kriterëve mjedisore dhe sociale, ndikimi mjedisor dhe social dhe vlerësimi i rrezikut, kontrolli i rrezikut dhe parandalimi dhe monitorimi i situatës së rrezikut mjedisor dhe social të huamarrësve.

Shqyrtimi i përmbushjes së kriterëve mjedisore bazohet në Listën kontrolluese mjedisore dhe sociale (e kompletuar nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Kredisë me informacionin e mbledhur nga Punonjësit në vijën e parë gjatë vizitës te klienti potencial) që përdoret për të monitoruar performancën mjedisore të klientit (emetimin e ajrit, emetimet e ajrit, ujërat e zeza, gjenerimin e mbeturinave, mbeturinat e rrezikshme etj.) përshkruajnë sistemet e menaxhimit dhe tiparet e zonës së projektit (afërsia e zonës së mbrojtur, vendi i trashëgimisë kulturore, lumenjtë dhe rrymat etj.). Në adresimin e ndikimeve të projekteve, Banka merr parasysh edhe periudhën e kthimit dhe madhësinë e huasë. Gjatë shqyrtimit projekti kontrollohet kundrejt Listës së përjashtimeve të grupit Raiffeisen dhe kundrejt Listës së Kategorizimit të Rrezikut të Projekteve (dallon rrezikun e lartë, të mesëm dhe të ulët), duke siguruar që një kujdes i duhur për mjedisin të aplikohet në projekt. Departamenti i Riskut dhe Menaxhimit të Kredive ka një matricë kundrejt së cilës vlerësohet niveli i rrezikut mjedisor dhe social. Për të gjitha projektet e kategorizuara si rrezik i lartë, procesi i kujdesit të duhur do të kryhet nga konsulentët e jashtëm, nëse konsiderohet e nevojshme. Gjetjet e procesit të kujdesit të duhur do të merren në konsideratë nga Organi Aprovues. Për projektet e rrezikut të mesëm, procesi i kujdesit të duhur të kryhet nga menaxherët e marrëdhënieve përkatëse (duke i siguruar informata Departamentit të Riskut) dhe nga

Menaxhimi i Riskut (duke plotësuar Listën kontrolluese mjedisore dhe sociale, duke plotësuar Matricën e Mjedisit dhe Shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve, dhe duke pasqyruar informacionin në deklaratën e CRM).

Sipas Politikave të Menaxhimit të Rrezikut Mjedisor dhe Social, Banka siguron që rregullorja kombëtare mjedisore dhe sociale respektohet plotësisht, duke respektuar kërkesat e IFO-ve partnere, për projekte afatgjata (mbi 10 milionë dollarë amerikanë dhe 36 muaj implementim) duke zbatuar Standardet e Performancës së IFC dhe për periudhën afatmesme (mbi 5 milion USD) aplikohen Standardi 1 Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale dhe 2 Fuqia punëtore dhe Puna. Në rastet kur ekspozimi i klientit është më i vogël se 36 muaj dhe shuma më pak se 35 milionë USD, aplikohen vetëm lista e përjashtimit dhe ligjet kombëtare për shqyrtimin e përmbushjes së kriterëve dhe kujdesin e duhur. Banka siguron që projekti të jetë në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të lartpërmendura.

Menaxheri Mjedisor dhe Social mbikëqyr menaxhimin mjedisor dhe social të Bankës dhe siguron zbatimin e SMMS, rishikon Raportin Vjetor të Performancës Mjedisore dhe Sociale si dhe raportin çështje kryesore në Bordin Menaxhues. Në nivelin e projektit, Menaxheri mjedisor dhe Social mbikëqyr performancën mjedisore dhe sociale të kompanisë së synuar për klient përmes shqyrtimeve të raporteve, vizitave në terren dhe regjistrimit të performancës mjedisore dhe sociale të klientit, shqyrton procedurat SMMS dhe siguron që rreziqet e projektit identifikohen dhe përpunohen në mënyrë adekuate përpunohen me kujdesin e duhur.

Banka gjithashtu ka vendosur një mekanizëm për zgjidhjen e ankesave për komunikim efikas dhe efektiv me klientët dhe publikun e gjerë.

Procedurat e menaxhimit mjedisor dhe social të bankës TEB Kosova

Menaxhimi mjedisor dhe social i projekteve në bankën TEB udhëhiqet nga Procedurat e Sistemit të Menaxhimit Social dhe Mjedisor të Bankës të nxjerra në Mars 2013. TEB synon të kryejë aktivitetet e saj në përputhje me Listën e përjashtimeve të IFC, Standardet e Performancës së IFC, të gjitha ligjet dhe rregulloret e Kosovës, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me ligjet dhe rregulloret mjedisore dhe sociale në Kosovë, fuqinë punëtore dhe punësimin, shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, klientëve dhe publikut të gjerë.

Objektivi i përgjithshëm i procedurave është që të përqendrohet në çështjet sociale dhe mjedisore të lidhura me huadhënien dhe investimet e mbështetura nga banka dhe më pas të minimizojë ekspozimin ndaj rreziqeve sociale mjedisore, sociale dhe përfundimisht atyre financiare. Objektivat specifike përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor të stafit si dhe ndikimet e mundshme në Bankë, identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve dhe çështjeve sociale dhe mjedisore që lidhen me operacionet e Bankës, si dhe identifikimin, matjen, kontrollin dhe monitorimin e ekspozimit të Bankës ndaj çështjeve sociale dhe mjedisore.

Në shqyrtimin e përmbushjes së kriterëve, TEB referohet në listën e përjashtimit të IFC si dhe listën e kategorizimit të riskut të IFC që korrespondon me kategorizimin e Grupit të BB, për këtë arsye dallon projekte të Kategorisë A (ndikime negative të konsiderueshme mjedisore që janë të ndjeshme, të ndryshme dhe të pashembullta), Kategorisë B (ndikime specifike mjedisore, pak prej tyre, nëse ka, të pakthyeshme) dhe C (pa ndikime të pafavorshme mjedisore). Banka TEB kërkon të japë vetëm për klientët operacionet e të cilave mbajnë rreziqe të ulëta dhe të mesme sociale dhe mjedisore.

Pas shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve nuk ndërmerren veprime të tjera për projektet e kategorisë C ndërsa për projektet e kategorisë B punonjësit e Bankës plotësojnë listën kontrolluese mjedisore dhe sociale në bazë të së cilës përcaktohen detyrimet. Rrjedhimisht, Banka siguron që janë marrë të gjitha lejet dhe licencat, si dhe se klienti është duke përmbushur të gjitha kërkesat sociale dhe mjedisore (duke përfshirë SHSP). Pasi të zbatohet projekti, përgjegjësia mjedisore dhe sociale përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë dhe monitorimi përcaktohet në procedurat e kredisë (afati i saj në një plan veprimi). Detyrimi i Huamarrësit për të raportuar mbi performancën mjedisore (Raporti vjetor i Raportit të Performancës është në dispozicion) dhe njofton Bankën në rast të mos-pajtueshmërisë, si dhe veprimet korrigjuese përcaktohen nga Procedurat.

Sistemi i Menaxhimit Social dhe Mjedisor (SEMS) mbikëqyret nga Zyrtarët e SEMS (Menaxhimi i Ndarjes së Kreditit dhe Divizionit të Monitorimit). Përgjegjësia përkatëse e menaxhimit është sigurimi i zbatimit të SEMS, koordinimi i aktiviteteve sociale dhe mjedisore, rritja e ndërgjegjësimit të secilit punonjës në lidhje me rreziqet sociale dhe mjedisore nëpërmjet trajnimeve të organizuara, si dhe për të siguruar që burime të mjaftueshme të brendshme të alokohen për zbatim efektiv të procedurave.

Qasja e ProCredit Bank në Kosovë për menaxhimin e ndikimit mjedisor dhe social të huadhënies

Si pjesë e grupit ProCredit, ProCredit Bank Kosova ndjek politikat dhe standardet e grupit të gjerë. Kjo përfshin standardet për menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale të aktiviteteve të saj të huadhënies, që është një element jetësor i qasjes në nivel grupi për menaxhimin e kujdesshëm të rrezikut.

Grupi ProCredit është i fokusuar në vendet që mund të karakterizohen si ekonomi në tranzicion dhe në zhvillim. Në disa prej këtyre vendeve ekziston një shkallë e ulët e zbatimit të standardeve dhe kërkesave mjedisore dhe sociale, të shoqëruara me një nivel joadekuat formalizimi.

Grupi ProCredit ka funksionuar me sukses për më shumë se dy dekada në këto mjedise dhe ka zhvilluar dhe zbatuar procese të fuqishme për operacionet e saj të huadhënies, që vlen edhe për ProCredit Bank në Kosovë. Këto janë të përshtatura për profilin e riskut të klientëve NVM, duke lehtësuar menaxhimin e suksesshëm të rrezikut kreditor, si dhe zbatimin e standardeve të larta mjedisore dhe sociale.

Grupi ProCredit zbaton praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me standardet bankare, mjedisore dhe sociale edhe pse operon në tregjet në zhvillim. Të gjitha bankat e ProCredit mbikëqyren nga Autoriteti Federal i Mbikëqyrjes Financiare i Gjermanisë (BaFin), dhe prandaj në shumicën e aktiviteteve të tyre veprojnë në përputhje me rregulloret bankare gjermane, përveç rregulloreve bankare vendase. Të gjitha bankat e ProCredit i nënshtrohen inspektimit të rregullt nga autoritetet rregullatore lokale, ndërsa grupi i nënshtrohet i mbikëqyrjes nga BaFin dhe Bundesbank. Grupi gjithashtu u përmbahet standardeve etike, mjedisore dhe sociale që priten nga aksionarët tanë kryesorë të orientuar kah zhvillimi.

Për shembull, grupi në të gjitha bankat e ProCredit zbaton kërkesat minimale gjermane për menaxhimin e riskut, zakonisht të referuara si MaRisk. MaRisk përcakton standarde strikte për menaxhimin dhe kontrollin e të gjitha rreziqeve materiale, duke përfshirë mbajtjen e kapitalit adekuat për mbulimin e rreziqeve të tilla. Grupi ProCredit përfshin standardet MaRisk në një sërë politikash të cilat duhet të praktikohen nga të gjitha bankat.

Në fushën e pastrimit të parave (AML) dhe parandalimit të krimit financiar dhe mashtrimit, të gjitha bankat ProCredit aplikojnë standardet rregullatore gjermane dhe të BE-së. Ryshfeti dhe korrupsioni nuk tolerohen në asnjë formë. Në të njëjtën mënyrë, është pjesë e misionit social të ProCredit-it për të këmbëngulur në shkallën më të lartë të transparencës dhe për të punuar vetëm me klientët që kanë burime të ligjshme të të ardhurave; bankat refuzojnë të bëjnë biznes me ndonjë klient që gjendet i angazhuar në aktivitete të paligjshme ose evazion fiskal.

Përgjegjësia për menaxhimin e riskut të kredisë qëndron në rend të parë te Departamentet e Riskut Kreditor të bankave ProCredit dhe drejtohet nga Komiteti për Menaxhim të Riskut në nivel të grupit dhe nga Departamenti i Riskut në nivel të grupit. Politikat e grupit për Menaxhimin e riskut Kreditor përcaktojnë përgjegjësitë e secilës prej këtyre palëve dhe përcaktojnë qartë parimet dhe detajet e menaxhimit të riskut kreditor.

Me lëshimin e lehtësirave kreditore, bankat synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes ekonomike të klientëve dhe familjeve të tyre dhe rrjedhimisht në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Për të siguruar që kreditë e dhëna nga bankat përdoren në përputhje me standardet etike, mjedisore dhe sociale të grupit, janë përcaktuar një sërë kriteresh të kualifikueshmërisë në Politikat e grupit për Menaxhimin e Riskut Kreditor. Këto kritere të kualifikueshmërisë përcaktojnë kërkesat lidhur me aktivitetin e biznesit të huamarrësit potencial, zbusin gjasat e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe marrin parasysh ndikimin mjedisor dhe social të aktivitetit të propozuar.

Menaxhimi i rrezikut mjedisor dhe social në huadhënie

Grupi ProCredit, duke përfshirë bankën ProCredit në Kosovë, vë theks të madh në menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe social (M&S) në huadhënie. Është një shtyllë e rëndësishme e sistemit tonë të menaxhimit mjedisor, që ka për qëllim zvogëlimin e ndikimit të tërthortë mjedisor të bankave të shkaktuara nga aktivitetet e tyre të huadhënies. Të gjithë klientët afarist që marrin financim duhet t'u përmbahen standardeve mjedisore dhe sociale siç janë përcaktuar në Standardet e

grupit për Menaxhimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social të Huadhënies, të cilat përfshijnë Udhëzimet për Vlerësimin Social dhe Mjedisor. Meqenëse rreziqet mjedisore mund të kthehen në rreziqe financiare për klientin, menaxhimi efektiv i rrezikut mjedisor dhe social ul riskun kreditor dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të klientëve tonë.

Përpyekjet në nivel grupi për të minimizuar rrezikun M&S nuk bazohen në një sistem të thjeshtë vlerësimi. Në vend që thjesht të refuzojnë afarizmin me kompanitë sepse ato nuk i plotësojnë kriteret e caktuara, bankat ProCredit preferojnë t'i angazhojnë ato në dialog për të diskutuar se si shërbimet e tyre mund të ndihmojnë në përmirësimin e performancës së tyre mjedisore dhe sociale në një mënyrë të shëndoshë ekonomike. Grupi ProCredit ka zbatuar procesin e mëposhtëm me tre hapa për menaxhimin e rrezikut M&S të huadhënies në përputhje me ciklin kreditor:

1. Shqyrtimi i përmbushjes së kriterëve nga aktivitetet e klientit kundrejt Listës së Përfshirimit (shpjeguar më poshtë në Politikën e Përfshirimit).
2. Përdorimi i një liste të paracaktuar për kategorizimin e aktiviteteve të klientit sipas shkallës së rrezikut mjedisor, shëndetësor dhe të sigurisë.
3. Kryerja e një vlerësimi individual të rrezikut mjedisor dhe social në lokacion.

Për të udhëhequr stafin tonë gjatë procesit analitik, grupi ProCredit ka dizajnuar një sistem të kategorizimit të rrezikut M&S bazuar në standardet ndërkombëtare që i caktojnë sektorët individualë të ekonomisë në kategorinë e rrezikut mjedisor të lartë, të mesëm ose të ulët, në varësi të ndikimit të tyre të mundshëm mjedisor dhe social. Kompanitë me aktivitete afariste që bien në kategoritë me rrezik të mesëm ose të lartë i nënshtrohen një vlerësimi individual të performancës së tyre në lidhje me çështjet mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë. Përveç kësaj, kryhet një vlerësim i kushteve sociale në një kompani për të gjithë klientët afaristë në mënyrë që të sigurohet se ekzistojnë kushtet e duhura të punës dhe se respektohen të drejtat e punës dhe të drejtat e njeriut.

Për vlerësimin e rreziqeve mjedisore, stafi i bankës mbështetet nga një formular vlerësimi për sektorë specifikë dhe nga shënimet udhëzuese të cilat theksojnë rreziqet e veçanta për secilin sektor. Kjo i mundëson stafit tonë që të kuptojë më mirë proceset dhe të zbulojë çdo çështje të mundshme, pikë në të cilën ata mund të diskutojnë masat e duhura me klientët për të përmirësuar performancën mjedisore dhe sociale të biznesit të tyre.

Qëllimi i këtij vlerësimi është që të sigurohet që pronarët e kompanisë janë të vetëdijshëm për të gjitha çështjet mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë dhe se ekzistojnë procese të përshtatshme për të menaxhuar rreziqet. Ne nxisim diskutime aktive me klientët tanë për të vënë në pah mundësitë e reja për investim ose ndryshimet e praktikave të zakonshme që mund t'i ndihmojnë ata të rrisin efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e burimeve. Në veçanti, ne shikojmë pajtueshmërinë ligjore; menaxhimin e tokës, mbeturinave, ujit, tokës, emetimeve dhe substancave të rrezikshme; sigurinë e lokacioneve dhe integritetin social. Për këtë qëllim, ne

ndërveprojmë me të gjithë klientët tanë drejtpërdrejt dhe kryejmë vizita në terren për të forcuar marrëdhëniet.

Përgjegjësia për vlerësimin e pajtueshmërisë mjedisore dhe sociale të klientëve tonë është ose e Këshilltarëve të Klientëve të Biznesit ose Zyrtarëve të Riskut Kreditor që kryejnë vlerësimin e rrezikut M&S në lokacion. Në varësi të ekspozimit dhe kategorisë së rrezikut mjedisor, përgatitet një vlerësim shtesë nga Zyrtari i Rrezikut Mjedisor, i cili është anëtar i specializuar i Departamentit të Riskut Kreditor dhe/ose kërkohet një VNMS shtesë i jashtëm. Komisioni i kredive merr vendimin përfundimtar nëse huaja miratohet ose refuzohet dhe nëse duhet të dakordohen kushte ose marrëveshje shtesë për të përmirësuar gjendjen në lokacion.

Politikat e përjashtimit

Përkundër qasjes tonë gjithëpërfshirëse dhe hapjes ndaj shumë modeleve të ndryshme të biznesit të klientëve tanë, ekzistojnë disa praktika dhe aktivitete të dëmshme që ProCredit Bank Kosova, si pjesë e grupit ProCredit, refuzon të mbështesë. Prandaj ne nuk mbështesim aktivitetet që janë të papërputhshme me vlerat tona etike, siç është prodhimi ose tregtimi i armëve, minierat nëntokësore dhe të ngjashme, edhe nëse aktivitetet e tilla janë ligjore. Është e qartë që aktivitetet që përfshijnë punën e detyruar, punën e fëmijëve, rivendosjen e pavullnetshme, prostitucionin, etj., janë gjithashtu të papranueshme. Ato janë përmbledhur në Listën tonë të Përjashtimeve.

Lista e Përjashtimeve në nivel grupi është e disponueshme në internet, e përfshirë në Kodin e Sjelljes së grupit dhe mund të shkarkohet nga seksioni i shkarkimeve në faqen kryesore të ProCredit Holding në <https://www.procredit-holding.com/downloads/> Versioni aktual i datës dhjetor 2018 gjendet më poshtë:

Nuk do të krijohen e as nuk do të mbahen marrëdhënie afariste me klientët e angazhuar në cilëndo nga aktivitetet vijuese:

Praktikat joetike dhe kushtet e punës:

- a) Prodhimi ose aktivitetet që përfshijnë forma të dëmshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar / punës së dëmshme të fëmijëve¹, praktikave diskriminuese ose praktikave që pengojnë punonjësit që të ushtrojnë në mënyrë të ligjshme të drejtat e tyre të asociimit dhe negociatave kolektive;
- b) Prodhimi ose tregtia e narkotikëve²
- c) Prodhimi ose tregtimi i armëve (përfshirë armët e gjuetisë) dhe municioneve³;
- d) Bixhozi (duke përfshirë bixhozin online), kazinotë dhe ndërmarrjet ekuivalente⁴;

¹ Kjo përfshin çdo aktivitet që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore. Punësimi i detyruar nënkupton të gjithë punën ose shërbimin, që nuk kryhet vullnetarisht, që nxirret nga një individ nën kërcënimin e forcës ose dënimit. Punësimi i dëmshëm i fëmijëve nënkupton punësimin ekonomikisht shfrytëzues të fëmijëve, ose që ka gjasa të jetë i rrezikshëm ose të ndërhyjë në edukimin e fëmijës, ose të jetë i dëmshëm për shëndetin ose zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social. Për udhëzime të mëtejshme referohuni: IFC (shih Deklaratën e Përbashkët të Politikave të IFC/MIGA mbi Punën e Detyruar dhe Punën e Dëmshme të Fëmijëve); Deklarata e ONP mbi Parimet Themelore dhe të Drejtat në Punë dhe parimet e mishëruara në konventat e mëposhtme: Konventat e ONP 29 dhe 105 (puna e detyruar dhe e lidhur), 87 (liria e asociimit), 98 (e drejta për negociatave kolektive), 100 dhe 111 (diskriminim); 138 (mosha minimale); 182 (format më të këqija të punës së fëmijëve); Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

² Termi "narkotikë" i referohet të gjitha barnave ilegale dhe sintetike të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope. Për referencë të mëtejshme ju lutem referojuni Konventës së Vetme të OKB-së për Drogat Narkotike (1961) si dhe Listës së Verdhtë të Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve (INCB).

³ Kompanitë e sigurimit që blejnë armë të vogla dhe municionet e tyre për përdorim vetjak dhe pa qëllimin e rishitjes së tyre, përjashtohen nga kjo dispozitë.

⁴ Kjo dispozitë përjashton lotaritë e bamirësisë, të cilat ekskluzivisht investojnë të ardhurat e tyre në aktivitete bamirëse për përfitim të përgjithshëm, si dhe ata persona ose subjekte që bëjnë më pak se 25% të qarkullimit të tyre duke ofruar lojëra të fatit.

- e) Nxjerrja e krypto-valutave ose operimi i platformave të shkëmbimit të krypto-valutave;
- f) Prostitucioni dhe çdo biznes për të cilin aktiviteti primar i biznesit lidhet me pornografinë;

Aktivitetet e dëmshme për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin:

- g) Prodhimi ose tregtimi ose përdorimi i fibrave të asbestit të papërpunuar ose produkteve që përmbajnë asbest⁵;
- h) Prodhimi ose tregtimi i produkteve që përmbajnë bifenile të poliklorinuar⁶;
- i) Prodhimi ose tregtimi i barnave, pesticideve/herbicideve dhe substancave të tjera të rrezikshme që i nënshtrohen largimit nga përdorimi ose ndalimeve ndërkombëtare⁷;
- j) Prodhimi ose tregtimi i materialeve radioaktive (duke përfshirë ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve radioaktive), biznesin ose aktivitetet që lidhen me industrinë bërthamore ose materialet bërthamore⁸;
- k) Peshkimi me rrjeta të mëdha në mjedisin detar duke përdorur rrjeta me gjatësi më të madhe se 2.5 km;
- l) Dërgesa e naftës ose e substancave të tjera të rrezikshme në depozita të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO)⁹;
- m) Aktivitetet që përfshijnë lirim të organizmave të modifikuar gjenetikisht në mjedisin natyror pa miratimin e autoriteteve kompetente ose kur autoriteti përkatës është shpallur si pa OMGJ¹⁰;
- n) Aktivitetet brenda zonave të mbrojtura të përcaktuara nën kategorinë I-IV të IUCN¹¹;
- o) Tregtia me kafshë të egra ose produkte të kafshëve të egra të rregulluara me CITES¹²;
- p) Lëvizjet ndërkufitare të mbeturinave të ndaluara sipas ligjit ndërkombëtar¹³;
- q) Ndërtimi i (mini-) hidrocentraleve pa vlerësim të duhur mjedisor;
- r) Prodhimi ose tregtimi i substancave që shpëtojnë ozonin, që janë objekt i largimit nga përdorimi në nivel ndërkombëtar¹⁴;

⁵ Kjo nuk vlen për blerjen dhe përdorimin e copëzimit të çimentos të asbestit ku përmbajtja e asbestit është <20%.

⁶ Bifenilet e poliklorinuar: grupi i kimikateve shumë toksike që mund të gjenden në transformatorët elektrikë të mbushur me vaj, kondensatorët dhe pajisjet që datojnë nga viti 1950-1985.

⁷ Një listë e produkteve që i nënshtrohen largimit nga përdorimi ose ndalimeve në faza është në dispozicion nga KFN ose BERZH. Dokumentet referuese përfshijnë Rregulloren e BE-së (EEC) Nr. 2455/92 në lidhje me eksportin dhe importin e disa kimikateve të rrezikshme, e ndryshuar; Lista e Konsoliduar e OKB-së e Produkteve Konsumi dhe/ose Shitja e të cilave është e ndaluar, tërhequr, rreptësisht e kufizuar ose jo e aprovuar nga qeveritë; Konventa mbi procedurat e miratimit paraprak të informuar për disa kimikate të rrezikshme dhe pesticide në tregtinë ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për ndotësit organikë të qëndrueshëm; Klasifikimi i OBSH për Pesticidet sipas Rreziqeve.

⁸ Kjo nuk vlen për blerjen e pajisjeve mjekësore, pajisjeve të kontrollit të cilësisë (matjeve) dhe çdo pajisje tjetër ku burimi radioaktiv është i parëndësishëm dhe/ose i mbrojtur në mënyrë adekuate.

⁹ Kjo përfshin: cisterna të cilat nuk kanë të gjitha certifikatat e MARPOL SOLAS (duke përfshirë, pa kufizim, pajtueshmërinë me Kodin e ISM), cisternat në listën e zezë të Bashkimit Evropian ose të ndaluara nga Memorandumi i Mirëkuptimit i Parisit për Kontrollin Shtetëror në Porte (MOU të Parisit) dhe tankerët që duhet të hiqen nga përdorimi në faza sipas rregulloreve 13G dhe 13H të Aneksit I të MARPOL-it. Nuk duhet të përdoret asnjë cisternë njëtrupëshe më e vjetër se 25 vite.

¹⁰ Për vendet ku operon BERZH: aktivitetet që përfshijnë lirim të OMGJ-ve në mjedisin natyror duhet t'i referohen BERZH-it dhe të krahasohen me kërkesat e zbatueshme të performancës.

¹¹ Aktivitetet brenda çdo zone tjetër të mbrojtur siç është përmendur në mënyrë specifike duhet të vlerësohen rast pas rasti sipas përcaktimit të Standardeve të Grupit për Menaxhimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social të Huadhënies. Zonat e tjera të mbrojtura mund të jenë p.sh. të klasifikuara nën kategorinë V dhe VI të IUCN, vendet e Trashëgimisë Natyrore të UNESCO-s, lokacionet e Ramsarit (Konventa mbi Ligatimet me Rëndësi Ndërkombëtare), Lokacionet e Emeraldit (Konventa e Bernës), Natura 2000.

¹² CITES Konventa mbi tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër. Lista e specieve të listuara në CITES është në dispozicion nga KNF ose BERZH. Për të gjetur se cilat lloje janë në listë, vizitoni <http://www.cites.org> ose vizitoni bazën e të dhënave të specieve CITES në <http://www.cites.org/eng/resources/species.html>

¹³ Dokumentet referuese janë: Rregullorja (KE) Nr. 1013/2006 e datës 14 qershor 2006 mbi dërgesat e mbeturinave; Vendimi C (2001) 107 / Final i Këshillit të OECD-së lidhur me rishikimin e Vendimit C (92) 39/Final mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të destinuara për operacione të rikuperimit; Konventa e Bazelit e datës 22 mars 1989 mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimit të tyre. Për informacion të mëtejshëm dhe një udhëzues të thjeshtuar për Konventën e Bazelit vizitoni <https://www.basel.int>.

¹⁴ Substancat Dobësuese të Ozonit (ODS): komponimet kimike të cilat reagojnë me dhe zhdukun ozonin stratosferik, duke rezultuar në vrmat e ozonit të publikuara gjerësisht. Protokollin i Montrealit liston ODS-të dhe reduktimin e synuar të tyre dhe datat e largimit nga përdorimi. Një listë e përbërjeve kimike të rregulluara me Protokollin e Montrealit, ku përfshihen aerosolët, ftohësit, agjentët që shpërndajnë pluhur, tretësit dhe agjentët e mbrojtjes nga zjarri, së bashku me detajet e vendeve nënshkruese dhe datat e synuara të largimit nga përdorimi, janë në dispozicion nga KNF ose BERZH.

- s) Operacionet e prerjeve komerciale ose blerjen e pajisjeve për prerjen e drunjeve për përdorim në pyjet primare të lagështa tropikale, prodhimin dhe tregtimin e drurit ose produkteve të tjera pyjore, me përjashtim të pyjeve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme¹⁵;
- t) Eksploatimi i minierave të diamanteve dhe komercializimi i diamanteve, kur vendi pritës nuk i është përmbajtur marrëveshjes Kimberley (KPCS) ose marrëveshjeve të tjera të ngjashme ndërkombëtare mbi burimet nxjerrëse.
- u) Miniera nëntokësore për nxjerrjen e metaleve, qymyrit, shistit të naftës dhe mineraleve të tjera.
- v) Prodhimi i qymyr drurit me metoda të ndryshme nga metoda e kthimit (përdorimi i kontejnerëve metalikë të mbyllur).

Aktivitetet që kanë një ndikim negativ në komunitet:

- w) Prodhimin ose tregtimin e ndonjë produkti ose aktiviteti që konsiderohet i paligjshëm nën ligjet ose rregulloret e vendit pritës (dmth. kombëtar) ose konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, duke përfshirë pa kufizim legjislacionin ose konventat në lidhje me mbrojtjen e burimeve të biodiversitetit ose trashëgimisë kulturore¹⁶;
- x) Aktivitetet brenda, afër, ose në kuadër të hapësirave tokësore që shfrytëzohen nga popujt indigjenë dhe/ose grupet e cënueshme, si tokat dhe rrjedhat ujore që përdoren për aktivitete të jetesës si kullotja e kafshëve, gjuetia ose peshkimi;
- y) Aktivitetet që mund të kenë ndikim të dëmshëm në lokacionet me rëndësi kulturore ose arkeologjike;
- z) Aktivitetet që përfshijnë rivendosjen e pavullnetshme;

Klientët e angazhuar në ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme nuk do të financohen:

- Prodhimi në masë ose tregtia e pijeve alkoolike (duke përjashtuar birrën dhe verën)¹⁷
- Prodhimi në masë ose tregtia e duhanit¹⁸

¹⁵ Pyjet e menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme duhet të certifikohen nëse ekziston mundësia (certifikuesit ndërkombëtarë dhe kombëtarë) ose duhet të jenë në pajtueshmëri me politikën e bankës për financimin e prerjeve.

¹⁶ Konventat përkatëse ndërkombëtare të biodiversitetit përfshijnë, pa kufizim: Konventën për mbrojtjen e specieve migratore të kafshëve të egra (Konventa e Bonit); Konventën për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht habitatët për shpendët e ujit (Konventa e Ramsarit); Konventën për ruajtjen e habitatit të kafshëve të egra dhe të natyrës (Konventa e Bernës); Konventën për trashëgimi botërore; Konventën për diversitetin biologjik

¹⁷ Kjo nuk vlen për klientët/ndërmarrjet të cilat nuk janë thelbësisht të përfshira në këto aktivitete. "Jo në thelb të përfshira" do të thotë se aktiviteti në fjalë është ndihmës në raport me operacionet primare të klientit. Përjashtime mund të bëhen me miratimin e KNF.

¹⁸ Njëjtë si e më parë